



DRITA ISLAME



*100 vjet*  
Komunitet Mysliman



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR  
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Erzen Carja

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit  
Nr. 02 (476)  
Shkurt, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.

## PËRMBAJTJA

4 Drita islame, në prag të 31 vjetorit / Mehmet Disha

6 100 vjet nga themelimi i komunitetit mysliman të shqipërisë / Dorian Demetja

10 Lajme / Aktivitete



14 Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 100 vjet në dritën e dëshmime historike / H. Bujar Spahiu

16 Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar, sanksionimi i mëvetësisë së Bashkërisë Islame të Shqipërisë, themel i zhvillimit kombëtar / Prof. Dr. Gazmend Shpuza

20 Si u bë mysliman Uahshiu, nga dora e të cilit ra dëshmor Hamzai (r.a.) / M. Jusuf Kandeheui

22 Njohuri me karakter historik / Nasuf T. Dizdari

26 Një lutje e Profetit tonë (a.s) / M. Fetah Resuloglu

28 Imperativi islamik për bashkim e vllaznim / Retrospektivë

30 Haxhi Vehbi Dibra klerik dhe patriot i devotshëm / Hamdi Basha



34 Efektet negative të egoizmit në familje / Aisa Kokiçi

36 Një rifreskim i Mjekësisë Profetike dhe bimore / Erion Sukaç



# “Drita Islame”

## NË PRAG TË 31 VJETORIT

njerëzimin.

Ishte po kjo porosi që la para më se dy dekadash "Pishtari i Ringjalljes së vlerave të Islamit", Hirësia e tij, H. Hafiz Sabri Koçi, Kryetari i parë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë pas viteve '90. Ai përgëzoi në atë kohë daljen në dritë të gazetës "Drita Islame", me urimin: "Mirë se na erdhe, o Drita Islame, që për gjysmë shekulli, mjegulla dhe retë e kohës penguan rrezet tuaja që të shihnin qartë jetën tonë e të na ndriçonin shpirtrat" (Drita Islame, nr. 1, 10 janar 1992).

Urimi për gazetën "Drita Islame" ishte njëherazi edhe përcjellja e vazhdimësisë së amanetit të diturisë, që vinte nga simotrat e kësaj luleje të kopshtit të dijes së myslimanëve në Shqipëri, pararendëset e saj, "Zani i Naltë" dhe "Kultura Islame", që kishin marrë jetë në fillimet e para të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Ndërsa në ditët e sotme, "Drita Islame" vjen me një tjetër vizion, një tjetër këndvështrim, një dritare të re të mendimit të myslimanëve të këtij nënqielli, por jo vetëm, një tjetër hap në kupolën e bashkëveprimit dhe harmonizimit të shërbimit që duhet t'i japim këtij vendi të mrekullueshëm, këtij populli fisnik dhe këtyre njerëzve të dashur.

Asnjëherë më shumë se sa sot njerëzimi nuk e ka pasur kaq të domosdoshme dhe jetësore nevojën për dije, përkushtimin ndaj saj dhe pritjen e ethshme nga ajo çfarë vjen prej saj.

Në Fjalën e Allahut të ardhur për mbarë njerëzimin dëshmohej qartë vërtetësia, fuqia dhe vlera e paçmuar e diturisë: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!" (Zumer, 9)

Ndërkohë që njeriu i ushqyer me Urtësinë Hyjnore, Mëshira e Botëve, i Dërguari i Fundit, me ëmbëlsinë më shumë se prindërore, me dashamirësinë që e veçonte nga çdo i dërguar tjetër, do të përcillte në rrjedhën e shekujve për gjithë njerëzimin: "Ose bëhu dijetar, njeri i dijes, ose ec në rrugën për të mësuar dije, ose përshko rrugën e sakrificës për dije, ose bëhu dashamir i botës dhe njerëzve të dijes..."

Për atë që është dhe përfaqëson, "Drita Islame" do vazhdojë të jetë drita e diturisë, drita e kthjelltësisë së mendjes dhe gjykimit, drita e edukimit dhe arsimimit, drita e shërbimit me aq devocion e çiltërsi, drita që do të lindë në horizontet e së nesërme, e së ardhmes më të ndritshme, më të begatë, jo vetëm për besimtarët e qytetarët fisnikë të Shqipërisë, por edhe për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Lutemi dhe shpresojmë që kjo dritë e pashuar, të jetë rrezja e diellit që vjen nga Drita e Përjetshme, dritë mbi çdo dritë, që ndriçon zemrat, shpirtrat, mendjet, gjykimet, arsytimet dhe hapat që hedh çdokush nga ne drejt së nesërme; që ndriçon shtëpitë, fshatrat e qytetet, Atdheun tonë aq të dashur e kombin tonë të shtrenjtë.

Kjo dritë dhe rrugëtimi i saj qoftë sihariqi më i madh për çdo zemër e çdo shpirt që dëshiron, lutet dhe përkushtohet ndaj të tjerëve për të ardhmen e pafundme.

Allahu Fuqiplotë i dhëntë krahë rrugëtimit të kësaj drite, këtij rrezatimi.

Në rrugëtimin tonë të gjatë drejt Providencës Hyjnore, për çdo hap që hedhim përgjatë kësaj rruge të ndritur, ajo që na prin dhe na jep shpresë e siguri në këtë udhë ka qenë dhe mbetet fuqia që buron nga dija. Kjo dituri është ajo që bën të mundur orientimin tonë, e që kur mbështetet në Shpalljen Hyjnore, përmasat që merr i kapërcejnë kufijtë e tokës dhe qiejve.

Madhështia e kësaj porte, që hap rrugën për të dy jetët, nis me të madhërishten fjalë nga Libri i Urtësisë Hyjnore: "Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)." (Alak, 1)

Lexo që të mund të hedhësh hapa drejt afrisë me Krijuesin; lexo që të mund të njohësh botën ku ke qenë, botën ku je, botën ku do të jesh; lexo që të mund të njohësh vetveten, materien dhe shpirtëroren, njerëzoren dhe hyjnore; lexo që të mund të hedhësh vështrimin përtej kufijve të njerëzores; lexo që të mund të arrish kënaqësinë e shpresës se tek Ai je i pranuar.

Nën harkun e portës së dijes, plejada të tëra dijetarësh, mendimtarësh, të përkushtuarish në dituri, do të linin pasardhës pikërisht këtë amanet me kaq vlera, amanetin e përcjelljes së diturisë, kësaj frymëmarrjeje jetësore për

*100 vjet*

**nga THEMELIMI  
I KOMUNITETIT MYSLIMAN  
TË SHQIPËRISË**

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë u themelua nga rilindës dhe firmëtarë të pavarësisë, si një bashkësi që do të përfaqësonte zërin e besimtarëve myslimanë në Shqipëri, trojet shqiptare, madje, në mjaft raste, edhe zërin e mbarë shqiptarëve. Ai që shënoi edhe pikënisjen drejt institucionalizimit të Bashkësisë Islame, ishte Kongresi i Parë i mbajtur më 24 shkurt deri më 12 mars 1923, që hodhi edhe themelet në formimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Qysh prej asaj kohe, besimtarët myslimanë shqiptarë do të përfaqësoheshin vetë dhe do t'i dilnin vetë për zot përhapjes e ruajtjes së traditës së bukur të besimit Islam.

Vitet '20 veçohen për një meritë të dyanshme. Për meritë të Komunitetit Mysliman Shqiptar, i cili, krahas mëvetësimit, kuptoi drejt rolin dhe pozicionin e vet në një shtet multifetar, duke ndërtuar një fizionomi të vetën, ngritur mbi postulatin "Dashuria për atdheun rrjedh nga besimi". Po ashtu, për meritë të shtetit shqiptar të asaj kohe, i cili në kushte kur i duhej të vetë-ndërtohej, diti t'i hapte rrugë ndërtimit të komuniteteve fetare, të afta për mbijetesë dhe ndërtimit me to të marrëdhënieve të drejta e ligjore, në pozitat e një shteti laik, i cili është i ndërgjegjshëm për vendin dhe rolin e religjionit në ngjizjen e një kombi vital dhe për të cilin të gjitha fetë janë njëlloj të respektueshme.

Nga gjysma e dytë e dhjetorit 1922, Haxhi Vehbi Dibra, i paraqiti qeverisë për miratim projektin e statutit të Xhematit Mysliman Shqiptar, për hartimin e të cilit kishte punuar nën kryesinë e tij, një komision i posaçëm i përbërë nga intelektualët më në zë të drejtuesve fetarë. Kongresin e parë të vitit 1923, do ta quanin Kongresi i themelimit të Komunitetit apo Bashkësisë Islame, i organizuar nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit me ndihmën aktive të qeverisë, duke filluar nga zgjedhja e delegatëve deri te shpenzimet e tyre.

Kongresi u përgatit dhe u hap me fjalën e H. Vehbi Dibrës, kryemyftiu i parë i Shqipërisë, emëruar nga qeveria e Ismail Qemalit pas Shpalljes së Pavarësisë. Në fakt, pavarësia e xhamisë shqiptare fillon qysh me këtë vendim, me idenë e qeverisë së Ismail Qemalit për ta emëruar vetë kryemyftiu e vendit. Kongresi vetëm do t'i jepte karakter traktateve të kësaj pavarësie. Rishfaqja e H. Vehbi Dibrës në këtë rol, që e kish marrë përsipër që më 1912, si detyrë dhe përgjegjësi kombëtare, shpreh një vijimësi përpjekjesh për një qëllim të lartë. "Dera e mejtimit të ixhtihadit (pikëpamjeve) nuk asht mbyllun dhe jemi gati për me i mejtue disa çështje fetare, se me ndërrimin e kohës, ndërrojnë edhe gjykimet", - u shpreh në fjalën e hapjes H. Vehbi Dibra.

Siç vihet re, një nga nismëtarët, organizatorët dhe drejtuesit kryesorë të këtij Kongresi e kishte ideuar dhe konceptuar këtë tubim në përputhje të plotë jo vetëm me interesat e bashkësisë islame, por dhe me

interesat e shtetit dhe të kombit shqiptar. Kjo detyrë e rëndësishme, sa fetare aq dhe atdhetare, mendohej të realizohej, çka është e kuptueshme, pa cenuar shtyllat e besimit islam. Pra, ky tubim nuk do të ishte një mbledhje e zakonshme e organizmave të bashkësisë islame në Shqipëri. Kryetari i këtij Kongresi vinte në këtë mbledhje me një koncept të qartë dhe të gjerë të detyrave që qëndronin përpara bashkësisë islame në Shqipëri, me një koncept bashkëkohor të masave dhe të vendimeve që duheshin marrë nga delegatët e zgjedhur.

Në vijim të fjalës së tij të hapjes, Kryemyftiu i Shqipërisë, duke marrë parasysh gjendjen fetare të vendit, shtronte para mbarë besimtarëve myslimanë detyrën për të vënë mbi gjithçka bashkimin dhe vëllazërimin kombëtar të mbarë shqiptarëve, pa dallim besimi. "Sikurse e dini zotëria e juaj, popullsia e Shtetit tonë përmbahet prej tre elementësh d.m.th. Mysliman, Katolik dhe Ortodoks, po në pikëpamje të Kombësisë në mest kemi një vllaznie të plotë e të patundëshme, e nuk mund të thohet e të kuptohet asnjë send qi e tund atë vllaznie të plotë. Çashtja e fesë asht një çashtje e posaçme e sejcilli asht i lirë për me e sigurue forcimin e fesë së vet. Ky organizim i fesë sonë asht vendosun qysh në Kongres të Dibrës. Fatzezë, po luftat ballkanike etj., e ndaluen këtë qëllim." Në seancën e dytë, Kongresi zgjodhi një komision që do të punonte për hartimin e statutit, i cili ishte dokumenti më i rëndësishëm i mbledhjes së myslimanëve shqiptarë. Komisioni që u ngarkua me përgatitjen e projekt-statutit i vazhdoi bisedimet dhe formuloi projektin e paraqitur, ku ndër të tjera shkruhej: "Sikurse shihet në këtë projekt-statut, duke u marrë parasysh qëllimet esenciale të organizimit, Statuti merr emrin Statuti i Trupit Xhema-atit Mysliman Shqiptar, në të cilin jemi munduar të përmbledhim disa themele për sigurimin e mbarëvajtjen e organizimit të këtij trupi për sa i përket sigurimit të një morali të pastër e zhvillimit lëndor e ekonomik, duke u larguar kryekëput nga politika. Përbërja e trupit mysliman shqiptar për sigurimin e qëllimeve të sipërshtënuara e forcimin vëllazëror ndërmjet shqiptarësh, i ngarkohet Këshillit të Naltë të Xhematit e ndihmës plot me vullnet të patundshëm të shqiptarëve myslimanë."

Në nenin 1 të këtij statuti shkruhej: "Për përmisimin e rregullimit të trupit Mysliman, u formue Xhema-ati Islamija në Shqipëri. Xhema-ati Islamija përmbahet me këto Këshilla: a) Këshill i Naltë i Sheriatit, b) Këshillat e Xhema-atit." Në statut, titulli i kadillikut e i nijabetit dhe fjala gjyq u hoqën, kryetarët e zyrrave sheri, tani e tutje do të përmbajnë titullin myfti. Ndërsa Gjyqi i Naltë i Sheriatit merr titullin Këshilli i Naltë i Sheriatit. Organi më i lartë mysliman në Shqipëri, po sipas këtij Statuti, ishte Kryesia e Këshillit të Naltë të Sheriatit. Kryesia e Këshillit të Naltë të Sheriatit drejtohej nga Myftiu i Përgjithshëm.

Rëndësi të madhe kishte fakti se Statuti Mysliman përjashtonte dhe ndalonte çdo autoritet shpirtëror jashtë Shqipërisë, çka e shihte atë kundër idealit kombëtar. Personi që do të vendosej të drejtonte Kryesinë e Këshillit të Naltë të Sheriatit duhet të kishte këto cilësi: Së pari, të ishte nënshkruar shqiptar dhe të dinte gjuhën shqipe; së dyti, të gëzonte të drejtat civile e politike; së treti, të ishte prej racës shqiptare ose me origjinë shqiptare prej tre brezash. Këtë post nuk mund ta zinin ata persona të cilët, duke filluar nga data 28 nëntor 1912 kishin luftuar kundër çështjes kombëtare. "Myftiu i Përgjithshëm do të ketë marrë ixhazet ose të ketë mbaruë shkollën e neyv-vabit, do të ketë zotsi të plotë në dijeni fetare e moral Kombtar, do të dijë me shkruar Shqip e do të ketë mbush 35 vjeçë e t'mos jetë i dënuë prej një gjyqit ordinerë."

Rëndësi të madhe kishte fakti se Statuti Mysliman përjashtonte dhe ndalonte çdo autoritet shpirtëror jashtë Shqipërisë, çka e shihte atë kundër idealit kombëtar. Personi që do të vendosej të drejtonte Kryesinë e Këshillit të Naltë të Sheriatit duhet të kishte këto cilësi: Së pari, të ishte nënshkruar shqiptar dhe të dinte gjuhën shqipe; së dyti, të gëzonte të drejtat civile e politike; së treti, të ishte prej racës shqiptare ose me origjinë shqiptare prej tre brezash. Këtë post nuk mund ta zinin ata persona të cilët, duke filluar nga data 28 nëntor 1912 kishin luftuar kundër çështjes kombëtare. "Myftiu i Përgjithshëm do të ketë marrë ixhazet ose të ketë mbaruë shkollën e neyv-vabit, do të ketë zotsi të plotë në dijeni fetare e moral Kombtar, do të dijë me shkruar Shqip e do të ketë mbush 35 vjeçë e t'mos jetë i dënuë prej një gjyqit ordinerë."

Në përfundim të punimeve më 12 mars 1923, Kryetari i Kongresit Mysliman Shqiptar Haxhi Vehbi Dibra i drejtoi Kryeministrit një letër ku e vinte në dijeni se Kongresi i kishte mbyllur punimet me sukses të plotë, duke zgjedhur në bazë të neneve 6 dhe 7 të statutit edhe anëtarët e Këshillit të Naltë të Sheriatit. Zgjedhjet u përfunduan si vijon: Z. Vehbi Dibra, vota 30 – dijetar (zgjidhet Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar); z. Hafiz Ali Korça, 29 vota – dijetar; z. Vejsel Nailiu 27 vota – dijetar; z. Haxhi Adem Bab 28 vota – tarikat; z. Sheh Ibrahim Karbunara 26 vota – tarikat. Nga civilët: Qamil Bala, vota 28 – civil; Reshat Kokalari 20 vota – civil; Drejtor i Përgjithshëm i Vakfeve u zgjodh z. Salih Vuçiterni me 32 vota. Me vendimet që mori, ai shënon një ngjarje të rëndësishme historike, jo vetëm për besimtarët e fesë islame, por për mbarë popullin shqiptar.

Në Statutin e vitit 1923, jo vetëm që nuk bëhej fjalë për ndonjë lidhje me kalifatin, por, konfirmoheshin 'de jure' vendimet e vitit 1913, kur si Myfti i Përgjithshëm i Shqipërisë ishte zgjedhur Haxhi Vehbi Dibra. Ky ishte dhe Kongresi i shpalljes së pavarësisë së xhamisë shqiptare, duke shkëputur kështu zyrtarisht çdo

marrëdhënie me Turqinë. Një akt i tillë u prit me entuziazëm dhe u komentua gjerësisht në faqet e shtypit të kohës. Deri më sot nuk kemi arritur të gjejmë ndonjë dokument mbi qëndrimin që mbajti Stambolli ndaj pavarësisë së xhamisë shqiptare. Ndonëse kjo ngjarje nuk mund të ketë kaluar pa u vënë re nga qeveria turke, fakt është se ajo nuk ndërmori ndonjë veprim apo reagim publik, për vetë faktin se bashkësia myslimane e Shqipërisë 'de facto' e kishte fituar mëvetësinë e saj që kur vendi ynë u shkëput nga Perandoria Osmane.

Kongresi hartoi Statutin, u mor me organizimin, caktoi kompetencat dhe të drejtat e tij, në pajtim me ligjet e shtetit në fuqi. Komuniteti doli si ent më vete; organizoi udhëheqësit fetarë, nëpunësit fetarë, shkollat dhe gjykatat fetare, të cilat zërthenin çështjet me karakter fetar – kurorëzime, divorce, trashëgimi dhe pasojat e tyre si dhe administronin pronat vakfnore. Ministria e P. të Brendshme me 8 prill 1923 njofton se të gjithë kleret, derisa çështja e tyre të rregullohet me ligj, do të varen nga Ministria e P. Brendshme.

Komuniteti përpiloi buxhetin e vet që e përballonte me të ardhurat e veta dhe me subvencionin që i jepte qeveria. Në këtë kohë Komuniteti mbante emrin "Xhema'ati Islamije", që përbëhej prej një Këshilli të Naltë të Sheriatit me pesë anëtarë, në krye të të cilëve qëndronte Myftiu i Përgjithshëm. Ky Këshill i Naltë zgjidhej nga Kongresi, ku merrnin pjesë delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë. Këshilli i Naltë zgjidhej për pesë vjet. Vartësit e Këshillit të Naltë ishin: 1) Myftinjët e qarqeve; 2) Sekretarët e vakfeve që merreshin me administrimin e të ardhurave vakfnore, 3) Sekretarët e sherisë, të cilët merreshin me martesat, shkurorëzimet, etj. 4) Mytevelijët që administronin mirëmbajtjen e pasurive vakfnore dhe faltoret.

Detyrat e Këshillit të Naltë të Sheriatit ishin: Të sigurojë njësinë dhe barazinë ndërmjet myslimanëve, si dhe të nxjerrë në pah shpirtin dhe qëllimin e Sheriatit, duke zhdukur të gjitha besëtytnitë dhe zakonet e këqija, të cilat nuk kanë të bëjnë fare me Islamin. Të ngrejë institucionet fetare për nxjerrjen e Vaizëve, Myftive, Myderrizëve, Teologëve, Imamëve dhe Hatibëve. Të përmirësojë punën në Medrese, sipas principeve dhe metodave moderne. Të ngrejë streha vorfënore, të studiojë dhe të shqyrtojë raportet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakfit, të kontrollojë buxhetin e përgjithshëm të përgatitur nga Drejtoria e Financës, të emërojë dhe të shkarkojë sipas rregullave të aprovuara të gjithë nëpunësit e Sherisë dhe të vakfeve, të shqyrtojë dhe të zgjidhë të gjitha akt-vendimet dhe fetvatë, të përgatisë rregulloren e administrimit të përgjithshëm. Të sigurojë botimin e një reviste të paktën njëherë në muaj, të botojë dhe të përkthejë librat e nevojshëm për shtimin e kulturës



islame, të përkujdeset për të ngritur më lart mësimin e besimit, si dhe të përgatiten në gjuhën shqipe hytбет dhe predikimet që mbahen para xhematit.

Vënia e veprimtarisë së Komunitetit Mysliman mbi baza ligjore, ngritja e një arsimit të qëndrueshëm fetar me programe të kohës, dhënia e një fryme kombëtare ceremonive fetare nëpërmjet përdorimit të gjuhës shqipe në predikime, mirëkuptimi në organizimin e drejtësisë mbi baza civile, ndërtimi i marrëdhënieve me shtetin në bazë të një kuptimi modern të një shteti laik, dhe, mbi të gjitha, pavarësia institucionale e Komunitetit Mysliman, si një vepër origjinale, janë gurë të një kurore plotësisht të merituar. Aktet e Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923, më shumë se në çdo rast tjetër, duke përfshirë edhe periudhën e sotme "të evropianizimit të përgjithshëm" përmbajnë një mendim të reformuar, liberal, të përshtatur për rrethanat e një shteti që jeton në mesin e Evropës, për të cilin feja është e ndarë nga shteti dhe çështje e individit. Komuniteti Mysliman arriti të vetorganizohet mjaft mirë, në një përvojë të re pothuaj të panjohur, ndërkohë që në plan kombëtar rrezaton një patriotizëm të flaktë dhe përgjegjshmëri të plotë ndaj problemeve sociale që kalonte vendi.

Administrata e Komunitetit Mysliman është vendosur fillimisht në godinën e Mejtepit në Pazarin e vjetër, tashmë i shkatërruar. Kurse ndërtesa e Komunitetit Mysliman u ndërtua në fillim të viteve 1930-të pranë Xhamisë së Vjetër (Sulejman Pasha), e cila është prishur me ndryshmet urbanistike që ka pësuar Tirana në vitin 1967.

Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar dëshmoi qartësisht tubimin e një bashkësie me identitet kombëtar të përcaktuar dhe të shprehur prej kohësh, me një përfytyrim bashkëkohor për zhvillimin e saj dhe të Atdheut. Lajmi për vendimin kryesor të Kongresit për mëvetësinë e xhamisë shqiptare, shkëputjen e saj nga organizmat qendrore botërore të Islamit të kohës, u prit kudo me miratim dhe entuziazëm të theksuar nga gjithë opinioni publik shqiptar. U përsëritet nga të gjithë banorët e vendit tonë, duke u shndërruar në një festë të vërtetë, në të cilën morën pjesë banorë pa dallim besimi. U bënë lutje fetare në gjuhën shqipe dhe ky lajm i rëndësishëm u përsëritet edhe me të shtëna artilerie.

Qëndrimet pozitive të mbajtura nga organet e shtypit islam dhe nga shtypi shqiptar i kohës për Kongresin, me ndonjë përjashtim shumë të rrallë, janë shprehje e një mendësie moderne mbarë-popullore, që kishte përfshirë të gjitha masat myslimane të vendit. Kongresi gëzoi edhe vlerësimin e vëmendjen e opinionit ndërkombëtar. Përveç shtypit vendas, gazetatat me emër si "New York Times" në Amerikë, "Temps" e Parisit, "El-Ahram" e Egjiptit ...etj, përsëritën Kongresin e Parë Mysliman dhe vendimet e tij.





## 1

**BASHKËPUNIMI I KMSH ME KRERËT E KOMUNITETEVE SHQIPTARE ISLAME TË DIASPORËS PËR PROJEKTET E RINDËRTIMIT NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI I 2019-TËS**

Krerët e Komuniteteve Shqiptare Islame të diasporës, si: z. Mehas Alija, Kryetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Zvicër, z. Vahedin Beluli, Kryetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Austri, z. Reshat Ibishi, Kryetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Itali, z. Usam Alimi, Nënkrjetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Austri, z. Besim Nuzi, Nënkrjetar i Bashkësisë Islame Shqiptare në Zvicër, të shoqëruar nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, inauguruan më datë 15. 01. 2023, shtëpitë e rindërtuara nga tërmeti i 2019-tës.

Projekti i rindërtimit, i vënë në jetë nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në total përfshiu 10 objekte banimi të ndërtuara nga e para dhe 8 të tjera të rikonstruara, si dhe ndërimin nga e para të xhamisë së "Thumanës".

Pas inaugurimit të shtëpive të banimit, Krerët e Komuniteteve Shqiptare Islame të Diasporës, të shoqëruar nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, inauguruan gjithashtu edhe objektin e xhamisë së "Thumanës".

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, përpos të lartpërmendurve, ishin të pranishëm gjithashtu edhe dhjetëra banorë të zonës, Nënkrjetari i Bashkisë së Krujës, z. Ilir Loci, Myftiu i Krujës, z. Ermir Gjana, Myftiu i Durrësit, z. Redin Quku, etj.

Simbolikisht u shpërndanë edhe çelësat e shtëpive të rindërtuara, të cilët ju dorëzuan kryefamiljarëve të pranishëm nga të lartpërmendurit.

Allahu (xh.sh) i shpërbleftë të gjithë ata që kontribuan, si në këtë botë po ashtu edhe në ahiret!





## 2

### MBLEDHJA E PARË E KËSHILLIT NDËRFETAR TË SHQIPËRISË

Më datë 23.01.2023, në selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u mbajt mbledhja e parë e këtij viti e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Kryetari Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, H. Bujar Spahiu, mikpritës i takimit. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Anastas Janullatos u përfaqësua në këtë mbledhje nga Hirësi Asti Bakallbashi. Kisha Katolike e Shqipërisë, Presidenti i Konferencës Ipeshkvnore, Mons. Angelo Massafra, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Kryegjyshi H. Dede Edmond Brahimaj Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, Kryetari, Pastor Ergest Biti, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, z. Genti Kruja si edhe Sheldiana Jano, Përgjegjëse e Financës në KNFSH.

Agjenda kryesore e mbledhjes së Këshillit të Presidencës të KNFSH-së ishte kalimi i detyrës së kreut të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë për vitin 2023, nga Pastor Ylli Doçi tek Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu në bazë të statutit dhe rotacionit të miratuar në mbledhjen e Këshillit të Presidencës së KNFSH-së.

Më tej mbledhja ka vijuar me paraqitjen e raporteve financiare të vitit 2022, miratimin e anëtarëve të rinj të Bordit Ekzekutiv. Gjithashtu është ndarë një informacion i përgjithshëm në lidhje me delegatët në Asambleenë e Këshillave Ndërfetarë të Europës, është diskutuar agjenda e vitit 2023 etj.





## 3

**ÇEL DYERT QENDRA RINORE E FORUMIT MYSLIMAN SHQIPTAR**

E konceptuar si një qendër shumëfunktionale, me ambiente biblioteka, klasa, ambiente pushimi dhe vendfalje (mesxhid), e tillë do të jetë Qendra Rinore e Forumit Mysliman Shqiptar (organ i KMSH) e cila hapi dyert, sot, ku ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, Nënkrjetari Bica, Drejtori i Kulturës Demetja, Përgjegjësi i Rinisë, z. Qëndrim Zogaj, drejtues të tjerët të KMSH dhe me praninë e shumë të rinjve.

Kjo qendër kulturore rinore vjen si nevojë e kohës për t'i ardhur në mbështetje studentëve që dëshirojnë të frekuentojnë të tilla ambiente kulturore dhe fetare. Ajo ndodhet në një zonë të aksesueshme dhe shumë të frekuentuar nga studentët, pranë ish-stacionit të trenit në Tiranë.

Forumi Rinor Mysliman Shqiptar (FRMSH) është një organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për të rinjtë të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e klubeve studentore, për ata që kanë dëshirë vullnetarizmi dhe angazhimi për t'i shërbyer vetvetes dhe shoqërisë.

Biblioteka e pasur me libra të ndryshme, klasat e studimit, ambientet e argëtimit (+kafe), mesxhid (vendfaljeje - burra & gra), do të jenë të hapura për çdo të ri që dëshiron të bëhet pjesë

Në këtë qendër studentët do të kenë mundësinë për të zhvilluar një sërë aktiviteteve duke përfshirë: seminare, kurse, klube studentore, trajnime, biseda fetare etj.

## 4

**FIRMOSET MARRËVESHJA PËR PROJEKTIN E SHPORTËS SË RAMAZANIT PËR VITIN 2023**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim z. Abdulkerim Al Jusuf dhe z. Abdulaziz Alrusajmi, përfaqësues të Qendrës Mbreti Selman për Bamirësi dhe Ndihma Humanitare me seli në Rijad të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Gjatë këtij takimi, kryetari Spahiu dhe përfaqësuesit e qendrës firmosën marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin nga ana e KMSH-së të projektit të Shportës së Ramazanit 2023.

Falë këtij projekti, me mbështetjen e qendrës në fjalë, KMSH do t'u vijë në ndihmë rreth 2000 familjeve nevojtare në mbarë vendin nëpërmjet myftinive nëpër rrethe me shporta ushqimore të mjaftueshme për një muaj.

Kjo traditë bashkëpunimi ndërmjet një prej qendrave humanitare më të fuqishme në lindjen e mesme dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë vazhdon me sukses prej tashmë 6 vitesh në vendin tonë.





## 5

### ZHVILLOHET KONFERENCA PËR VLERËSIMIN E PROJEKTIT: "ANGAZHIMI I TË RINJVE PËR NDËRTIMIN E NJË KOMUNITETI TË QËNDRUESHËM"

Zhvillohet konferenca për vlerësimin e impaktit të projekteve: "Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm", projekte këto të zhvilluara ndër vite me mbështetjen financiare të Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë dhe të implementuara nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.

Në ceremoninë hapëse të kësaj konference, e cila u zhvillua më datë 16.02.2023, në ambientet e "Tirana International Hotel", ishin të pranishëm: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Zv. Ambasadori Amerikan në Tiranë, z. Demian Smith, Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Klodjan Bulku, Zëvendësministrja e Ministrisë së Brendshme, znj. Romina Kuko, Drejtori i Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri (CVE), z. Denison Meidani, Koordinator i këtij projekti ndër vite, z. Fejzi Shaholli, si dhe myftij, imamë, studentë, të rinj të ndryshëm, etj.

Pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, z. Shaholli, ndau me ta një tablo përshkruese të këtyre projekteve. Implementimi i të cilëve u bë gjithësej në 6 vite, ku morën pjesë rreth 3.395 persona të grupmoshave dhe kategorive sociale të caktuara, si dhe u zhvilluan 156 seminare, 34 miniprojekte dhe 22 sesione informuese në 15 zona të ndryshme të vendit tonë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari Spahiu, u ndal në qëndrimet e KMSH-së dhe punën konkrete që është bërë vit pas viti për parandalimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në shoqërinë tonë.

Ndërsa Zëvendës Ambasadori Amerikan në Tiranë, z. Smith, u shpreh falenderues për bashkëpunimin e frytshëm që ka karakterizuar të dy institucionet në implementimin e këtij projekti ndër vite.

Punimet e kësaj konference u zhvilluan më tej në sesionin e dytë dhe të tretë të saj. Sesione në të cilat u analizua ecuria e projekteve, u analizua gjithashtu impakti i tyre në të gjitha ato kategori sociale që u bënë pjesë, u ndanë eksperiencat personale nga pjesëmarrja në këto projekte, etj.



# *Komuniteti Mysliman i Shqipërisë*

# 100 vjet në dritën e dëshmimeve historike

Pavarësia e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë është ndër aktet më të rëndësishme kombëtare, pas pavarësisë së Shqipërisë. Kleri mysliman në përgjithësi, por edhe dijetarë e hoxhallarë të spikatur kanë rolin e tyre vendimtarë në pavarësinë e Shqipërisë. Në këtë vazhdë ata nuk u ndalën vetëm me pavarësimin e vendit, por më 24 shkurt të vitit 1923 nisën rrugën e pakthyeshme për mëvetësinë e Komunitetit Mysliman.

Dijetarët myslimanë të tillë si Daut efendi Boriçi, H. Ymer Prizreni, së bashku me bashkëkombas të tjerë, u prinë proceseve të tilla kohë më parë, qysh me kuvendin e Lidhjes së Prizrenit në xhaminë Bajrakli dhe Medresenë e Mehmet Pashës, që sot njihet si muzeu i Lidhjes së Prizrenit.

Pra, në çdo moment historik që i ka kontribuar pavarësisë, shtet-formimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, prijësit e fesë Islame kanë qenë aty dhe kanë dhënë kontribut domethënës e definitiv në momente të caktuara.

Komunitetit Mysliman i Shqipërisë është themeluar nga rilindas dhe firmëtarë të pavarësisë 100 vjet më parë, si një bashkësi që do të përfaqësonte zërin e besimtarëve myslimanë në Shqipëri, trojet shqiptare, madje, në mjaft raste edhe zërin e mbarë shqiptarëve.

Në arkivat që na janë përcjellë, gjenden mjaftueshëm fakte dhe dokumente autentike, të cilat tregojnë se ky

institucion është vazhdimësia e institucioneve islame, që ekzistonin prej shekujsh në vendin tonë nëpërmjet myftinive, trupave gjyqësore të shariatit me kadinjtë e famshëm, medreseve dhe mejtepeve, të shtrira pothuajse në çdo hapësirë shqiptare.

Është nder dhe privilegj i jashtëzakonshëm për mua, si kryetari i 10-të i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë t'i shërbej fesë sime të bukur, besimtarëve dhe kombit tim në një moment të tillë historik, siç është 100-vetori i pavarësisë.

Nga dijetari i madh H. Vehbi Dibra e deri në ditët e sotme, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka dhënë dhe jep një kontribut të paçmuar sa i përket harmonisë fetare në Shqipëri.

Në këtë shekull plot sfida, Komuniteti Mysliman i ka shërbyer fesë Islame me besnikëri, përkushtim e devocion të lartë dhe po me të njëjtë përkujdesje i ka shërbyer kombit, çështjes kombëtare në tërësi.

Një kontribut tejet jetik për fenë islame dhe shoqërinë shqiptare në tërësi, komuniteti mysliman ka dhënë edhe në fushëm e arsimit e kulturës.

Revistat kulturore e shkencore, institucionet arsimore si medresetë, hapja e Universitetit BEDER, jeta edukative nëpër xhamitë e vendit, kanë qenë elementët bazë mbi të cilat ka bërë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë rrugëtimin e tij të sukseshëm në 100 vite.





# KONGRESI I PARË MYSLIMAN SHQIPTAR

**SANKSIONIMI I MËVETËSISË  
SË BASHKËRISË ISLAME  
TË SHQIPËRISË, THEMEL I  
ZHVILLIMIT KOMBËTAR**





Kongresi Mysliman Shqiptar për-faqëson një ngjarje shumë të rëndë-sishme, jo vetëm për jetën fetare, shoqërore e shpirtërore të shqiptarë-ve, por edhe për jetën politike kom-bëtare të mbarë popullit tonë. Është një moment që ka tërhequr fare pak, madje më tepër vëmendjen e autorë-ve të huaj, pa arritur të vlerësohet sa dhe si duhet në shkallën që i takon. 90- vjetori i tij na jep rastin të ndalemi dhe të fillojmë ta vëmë në vend këtë moment të historisë kombëtare, të cilit historiografia jonë i ka jo pak borxh.

Vendimet e qeverisë së Vlorës për mëvetësimin e komunitetit islam në vendin tonë, në përputhje me realitetin e ri politik, të krijuar me Shpalljen e Pavarësisë, kishin hedhur prej kohësh bazën për ndërmarrjen e nismës për mbajtjen e Kongresit të parë Mysli-man Shqiptar, i cili nuk do të bënte gjë tjetër veçse do të sanksiononte këtë akt. Fjala është për caktimin e kryemyftiut dhe kryekadiut të Shqi-përisë, pa pyetur qendrat përkatëse në Stamboll.

Thirrjet për pavarësimin e xhamisë dhe krijimin e Bashkësisë Islame në Shqipëri, qenë lëshuar që më 1921. Realizimi i kësaj dëshire dhe detyre u bë i mundur 90 vjet më parë, më 24 shkurt 1923.

Detyra e parë e Kongresit ishte shpallja e mëvetësisë së Xhamisë shqiptare. Kongresi, siç

mendohej, do të merrej edhe me çështje të tjera të karakterit arsimor- kulturor dhe, madje, dhe shoqëror, si predikimi në gjuhën amtare e të tjera.

"Sot Kur'ani, - pohonin në shtypin e kohës, - jo vetëm nuk të ndalon të shkruash me karakter latinisht shqi-pen, por të thotë dhe t'i lutesh Zotit në gjuhën tënde, që Kur'anin mund ta përkthesh dhe të mos kesh gjynah, por përkundrazi".

Në krye të kësaj nisme përthirrjen, organizimin, mbajtjen dhe përfundim-min me sukses të Kongresit të Parë Mysliman Shqiptar, u vunë jo rastë-sisht elementë të tillë si Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu e të tjerë. Ata qenë jo vetëm di-jetarë të shquar islamë, por dhe vep-rimtarë aktivë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Haxhi Vehbi Dibra në fjalën e tij të hapjes në Kongres, pasi vuri në pah karakterin liberal e demokratik të fesë myslimane, theksoi se: "...dera e mejtimit të ixhtihadit (pikëpamjeve) nuk asht e mbyllun dhe jemi gati për me i mejtue disa çashtje fetare, se me ndërrimin e kohës ndërrojnë edhe gjy-kimet". Siç shihet, organizatorët dhe drejtuesit kryesorë të këtij Kongresi e kishin ideuar këtë tubim jo si një mbledhje të zakonshme organizati-ve të bashkësisë islame në Shqipëri. Ata vinin në këtë mbledhje me një mendim të qartë dhe largpamës të detyrave që qëndronin para tyre.

Kryemyftiu i Shqipërisë u kujtonte delegatëve gjendjen mikse të vendit në pikëpamje fetare dhe detyrat e besimtarëve për të vënë mbi gjithçka, çka vlen të nënvizohet, bashkimin kombëtar pa dallim besimi e, madje, vëllazërimi kombëtar të të gjithë shqiptarëve. "Sikurse e dini zotëria juaj, popullsia e shtetit tonë përmbahet prej tre elementesh, d.m.th. Musliman, Katolik dhe Ortodoks, po në pikëpamje të kombësisë në mes kemi, - iu drejtua Vehbi Dibra delegatëve, - një vllaznie të plotë e të patundshme, e nuk mund të thohet e të kuptohet asnjë send që e tund atë vllaznie të plotë. Çashtja e fesë asht një çashtje e posaçme e sejcili asht i lirë për me sigurue forcimin e fesë së vet".

Vehbi Agolli (Dibra), pjesëtar aktiv i Kuvendit të Vlorës, i zgjedhur kryetar i këtij kuvendi historik e më pas kryetar i senatit, të dalë prej tij, jo rastësisht u vu në krye të këtij Kongresi. Për më tepër ai qe emëruar nga qeveria e Vlorës, kryemyfti, ndërsa Vejsel Naili kryekadi i Shqipërisë.

siç kuptohet, e debateve jo të pakta të zhvilluara në gjirin e Kongresit, nuk bëhet fjalë shprehimisht për shpëputjen e Bashkësisë Islame Shqiptare të porsa organizuar nga Kalifati dhe Meshihati i Stambollit. Një fakt i tillë, nuk ka dyshim që nënkuptohet, a më mirë të thuhet, as nuk diskutohet, përderisa në këtë Statut nuk bëhet fjalë, gjithashtu, për kurrfarë lidhjeje fetare organizative me Stambollin, as me Kalifatin dhe me Shejhul-Islamin. Gjithë organizimi dhe funksionimi i kësaj Bashkësie ishte menduar i pavarur nga asnjë qendër tjetër fetare e huaj, kushdo qoftë ajo. Këshilli i Lartë i Sheriatit zgjidhet nga Kongresi i Bashkësisë Islame Shqiptare me shumicë votash dhe të gjithë anëtarët e tij duhet të ishin me kombësi apo, siç theksohet në Statut, prej racës shqiptare.

Pra, mbetet jashtë çdo dyshimi se Bashkësia Islame Shqiptare u shkëput, tashmë edhe juridikisht, nga qendra e saj botërore, Kalifati. Me këtë organizim sanksionohej de jure ajo gjendje e krijuar de fakto që para 11 vjetësh, pas Shpalljes së Pavarësisë, me vendimet e Qeverisë së Vlorës për emërimin e kryemyftiut dhe kryekadiut të Shqipërisë.

Në detyrat kryesore të Këshillit të Naltë të Sheriatit rreshtohen:

"Të sigurojë nisjen (Bashkimin -G.Sh.) ndërmjet muhamedanve dhe të shfaqë shpirtin liberal Hyr dhe ndjerzuer të muhamedanizmës me një zhvillim modern (aser) e kombëtar tuej bamë reforma pa i prekë themelet fetare."

Detyrë parësore e këtij organizmi të lartë

të Bashkësisë Islame Shqiptare qëndronte gjithashtu dhe përmirësimi i medreseve, siç theksohet, "mbas reformave të reja" dhe mbi baza kombëtare shqiptare. Forumi më i lartë islam në Shqipëri, në mënyrë të veçantë, do "Të përkujdeset me sigurue mësimin fetar e të përgatisë në gjuhën kombëtare Hytbeh dhe predikime e libra sipas shekullit të sotëm". Prandaj nëpër faqet e shtypit ato ditë vazhdonin të informonin, se midis risive, të diskutuara, mendohet, që të zëvendësohet arabishtja me shqipen në predikimet kanonike.

Nga jehona që pati në shtyp dhe nga vendimet e marra në kongres del plotësisht e qartë, se gjithë shqetësimi i delegatëve pjesëmarrës ka qenë vënia e organizimit dhe e funksionimit të Bashkësisë Islame të Shqipërisë mbi baza kombëtare dhe më bashkëkohore. Ky kujdes shihet në detyrat që parashtrroi Kongresi, duke filluar nga sigurimi i karakterit etnik shqiptar të vetë përbërjes së këtij organi më të lartë të fesë myslimane në vendin tonë.

Lajmi për vendimet kryesore të Kongresit, u prit kudo, siç kumton shtypi i kohës, me miratim dhe entuziazëm të theksuar nga gjithë opinioni publik shqiptar, pavarësisht nga besimi. U përshëndet në shkallë të gjerë, duke u shndërruar në një festë të vërtetë. U bënë lutje fetare, në të shumtën e rasteve, siç theksohet, në gjuhën shqipe. Ky lajm i rëndësishëm u përshëndet, madje, dhe me të shtëna artillerie.

Si përfundim, mund të konkludohet, se Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar sanksionoi mëvetësinë apo, siç shprehet shtypi, autoqefalinë e bashkësisë islame në Shqipëri. Ai programoi punë për shqipërimin e veprave fetare islame, duke mos përjashtuar edhe vetë Librin e Shenjtë, Kur'anin. Kësaj pune madhore iu vunë ideologë të mirënjohur fetarë dhe laikë si: Sh. Muka, F. Vokopola e të tjerë. Midis tyre bie në sy, madje dhe ndonjë bashkatdhetar i krishterë si I. M. Qafëzezi dhe shquhet Hafiz Ibrahim Dalliu.

Megjithëse vendimet e Kongresit Mysliman Shqiptar ndeshën në ndonjë rast dhe në qëndrime jo të drejta të rretheve të caktuara fanatike të huaja e vendase, pavarësisht nga besimi, kleri atdhetar dhe i kulturuar mysliman vazhdoi punën e tij përparimtare të filluar në Kongresin e Parë.

Qëndrimet intolerante nuk arritën, në fund të fundit, të ushqenin artificialisht frikën se mos me organizimin kombëtar dhe bashkëkohor të Bashkësisë Islame dobësohehin pozitrat e besimit islam në Shqipëri. Në të vërtetë, Kongresi

hidhte bazat e forcimit të tyre në frymën e kërkesave bashkëkohore dhe të vetë pozitës evropiane të vendit tonë, çka kërkohej me forcë asokohe.

Formimi i Këshillit të Lartë Mysliman Shqiptar si organi më i lartë i Bashkësisë Islame Shqiptare, ishte një për-gjigje e qartë në momentin e duhur ndaj përpjekjeve që kishin filluar po në atë kohë për formimin e një komiteti panislamik në Shqipëri.

Parë me këtë sy, përballë përpjekjeve që po bëheshin në këtë drejtim për të formuar një organizëm me një fizio-nomi panislamiq, krijimi i Bashkësisë Islame në Shqipëri mbi baza kombëtare dhe i organit të saj të pavarur nga një qendër e huaj, e jashtme, shënon një sukses shumë të madh, jo vetëm për atë kohë, por edhe për të ardhmen, për vetë fatet e kësaj Bashkësie dhe të bashkëjetesës me vëllezërit e krishterë.

Përpjekjet për organizimin modern të Bashkësisë islame në përputhje me kërkesat bashkëkohore dhe pozitën gjeopolitike evropiane të Shqipërisë përbëjnë një meritë jo të vogël të organizatorëve sa atdhetarë, aq dhe të emancipuar e largpamës të këtij Kongresi, jo vetëm në kuadrin shqiptar, por dhe më gjerë.

Vendimet e Kongresit Mysliman në mars 1923, ashtu sikurse dhe vendimet e Kongresit Bektashian të Prishtës, në janar 1922 dhe të Kongresit të Kishës Ortodokse në Berat, në shtator 1922, i vunë organizmat fetare të masës dërrmuese të popullsisë shqiptare në vendin tonë mbi baza kombëtare, administrativisht dhe organizativisht, jashtë ndikimeve politike të huaja, të dëmshme apo të rrezikshme. Me këto vendime viheshin më tej në jetë idealet e rilindësve tanë për sigurimin e bashkimit dhe vëllazërimit kombëtar të mbarë shqiptarëve pa dallim besimi.

Vendimet e qeverisë së Vlorës për riorganizimin e ko-munitetit islam në vendin tonë në përputhje me realitetin e ri politik të krijuar me Shpalljen e Pavarësisë dhe sido-mos vendimet e Kongresit Mysliman Shqiptar të vitit 1923 dëshmojnë katërcipërisht që në Shqipëri kemi pasur dhe kemi të bëjmë me një bashkësi islame të organizuar mbi baza kombëtare dhe të prirur fuqimisht drejt zhvillimeve bashkëkohore.

Mëvetësimi i Bashkësisë Islame nuk i cenoi ndjenjat dhe bindjet fetare të besimtarëve. Përkundrazi, ai hapë rrugën për zhvillimin e tyre mbi bazën e besimit të vërtetë, të zhveshur nga shtresat dhe paragjykimet e huaja jo vetëm me traditat e vendit tonë, por edhe me vetë thelbin e këtij besimi. Këto qëndrime tolerante të besimtarëve

myslimanë shqiptarë dhe të vëllezërve të tyre të krishterë ishin dhe mbeten provë dhe dëshmi e dëshirave dhe e aftësive të tyre për t'u integruar në qytetërimin bashkëkohor. Ato në të njëjtën kohë janë dhe një kontribut jo i vogël që pasuron qytetërimin evropian.

Në dritën e këtyre vendimeve dhe këtyre qëndrimeve në revistën "Zani i Naltë" dhe më gjerë në shtyp shtrohej me forcë që myslimanizmi të zhvillohej më tej në luftë me fanatizmin, të ecte përkrah qytetërimin bashkëkohor, çka përbënte, sipas autorëve të këtyre shkrimeve, një kërkesë të vetë fesë myslimane të konsakruar dhe me librin e shenjtë, Kur'anin.

Feja asnjëherë nuk i ka penguar shqiptarët, përfshirë myslimanët, që të përqafojnë dhe të përvetësojnë arritjet e qytetërimin modern perëndimor dhe të kulturës përparimtare evropiane. Depërtimi i ideve iluministe evropiane dhe të çdo gjëje të mirë të arritur në Perëndim midis shqiptarëve, çka besohet se nuk mund të vihet në dyshim dhe nuk ka nevojë të provohet, në përgjithësi, nuk mund të arrihej kurr-sesi pa mbështetjen dhe pjesëmarrjen aktive të shqiptarëve myslimanë, që përbëjnë pjesën dërrmuese të kombit.

Detyrat e shtruar që në Kongresin e Parë Mysliman të Shqipërisë mbeten aktuale dhe sot e kësaj dite. Fjalët e organizatorit dhe kryesuesit të tij, klerikut të lartë dhe atdhetarit të shquar Haxhi Vehbi Dibrës, për karakterin liberal e demokratik të fesë myslimane, e cila i ka hapë lirisht portat për diskutimin e lirë të të gjitha problemeve që i interesojnë botës myslimane i kanë qëndruar kohës dhe vlejné dhe për të ardhmen.

Shprehim bindjen se Bashkësia Islame e Shqipërisë do të ecë edhe në të ardhmen në rrugën e hapur nga Kongresi Mysliman i vitit 1923, duke iu përmbajtur vazhdimisht frymës dhe vendimeve të tij, për të vënë mbi gjithçka bashkimin kombëtar pa dallim besimi e, madje, për të ruajtur atë "vllaznie, siç u tha në Kongres 90 vjet më parë, - të plotë e të patundshme" midis shqiptarëve.

Gatishmëria e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në shenjë më të parë që u dha me sensibilizimin që iu bë në gazetën "Rilindja", për përkujtimin e kësaj ngjarjeje me rëndësi historike jo vetëm fetare, por edhe kombëtare mbarë shqiptare, flet qartë për atë që ai është i ndërgjegjshëm për detyrat që ka parashtruar ai Kongres jo vetëm në ruajtjen e karakterit kombëtar të Bashkësisë Islame të Shqipërisë, por dhe për zhvillimin modern të saj. Pra, detyrat e parashtruar 90 vjet më parë mbeten aktuale dhe sot e kësaj dite.

# SI U BË MYSLIMAN UAHSHIU, NGA DORA E TË CILIT RA DËSHMOR HAMZAI (R.A.)



Uahshiu, pasi vrau Hamzanë (radijallahu anhu) dhe ky i fundit hyri në radhët e dëshmorëve, u kthye për në Mekë. Kur myslimanët ngadhënjyen mbi Mekën, ai u arratis në Taif. Por edhe banorët e Taifit kishin filluar të shkonin të gjithë për të pranuar Islamin. Nuk kishte ngelur më asnjë vend ku të mund të fshihej Uahshiu.

Krenaria e Gjithësisë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi lajm se ai e ftonte Uahshiu që të pranonte fenë islame dhe të bëhej mysliman. Ndërsa Uahshiu i ktheu këtë përgjigje të Dërguarit të Allahut: "O Muhamed! Si është e mundur që ti më fton mua të pranoj Islamin? Ata që i bëjnë shirk Allahut [shën. ynë. shirk ~ t'i bësh Zotit bashkëshoqërim, apo ortakëri, në krijim dhe në adhurim], që vrasin padrejtësisht një jetë të pafajshme dhe bëjnë zina do të vuajnë dënimin e tyre. Në ditën e Kiametit, kur të vijë çasti i asaj përballjeje të madhe, ndëshkimi i tyre do të jetë i shumëfishtë e ata do të qëndrojnë në të, të mbërthyer nga vuajtjet dhe poshtërimi. E unë i kam bërë të gjitha këto. A mund të ketë shpëtim për një njeri si unë?" Menjëherë pas kësaj, Allahu (xhel'le xhelaluhu) zbriti këtë ajet: "Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë." (Furkan, 25/70)

Kur mori vesh këto fjalë, Uahshiu tha: "O Muhamed! Të kthesh e të besosh dhe të bësh punë të mira' është një kusht shumë i rëndë për mua. Po të jetë për mua unë nuk mendoj se mund ta përballoj dot diçka të këtillë."

Fill pas kësaj përgjigjeje pati zbritur edhe një tjetër ajet: "Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm." (Nisa, 4/48)

Prapëseprapë, Uahshiu, megjithëse e dëgjoi ajetin, i ktheu përgjigje Profetit tonë të nderuar: "O Muhamed! Çfarë mendimi ke ti për këtë çështje? Të falurit varet nga urtësia dhe vullneti i Allahut. Nuk e di; a më fal, apo nuk më fal Ai mua?" – kësaj duke e pyetur të Dërguarin e Allahut. Edhe për këtë zbriti menjëherë një ajet tjetër, në të cilin thuhej: "Thuaj: 'O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.'" (Zumer, 39/53)

Uahshiu kishte marrë pikërisht përgjigjen që po kërkonte. U bë menjëherë mysliman. Madje disa njerëz thanë: "O i Dërguari i

Allahut! Edhe ne kemi bërë të këqija njësoj si Uahshiu. A janë të vlefshme edhe për ne këto kushte?"

- "Këto kushte janë të vlefshme për të gjithë myslimanët.", – u përgjigj Krenaria e Gjithësisë.<sup>1</sup>

### **Kur Fatimja e nderuar zuri të qajë nga vështirësitë që kishte gjatë kohës që Resulullahu ftonte njerëzit në besim**

Ebu Thalebe el-Husheniu tregon: "I Dërguari i Allahut (alejhis'selam) sapo ishte kthyer nga lufta. Hyri drejt e në faltore dhe fali dy rekate namaz. Puna e parë që Krenaria e Gjithësisë bënte kur kthehej nga ndonjë betejë ishte falja e dy rekateve namaz, mandej shkonte menjëherë për te e bija, Fatimja, për ta pyetur se si ishte dhe a kishte ndonjë gjë që e kishte mërzitur, pastaj shkonte pranë grave të tjera. Njëherë, kur u kthye, fali dy rekate namaz në faltore, pastaj, pa shkuar te asnjë prej grave të Tij, shkoi menjëherë pranë vajzës së Tij, Fatimes. E bija e priti që te porta. Fatimja zuri ta puthte babanë nga fytyra dhe sytë dhe filloi të qante. I Dërguari i Allahut e pyeti të bijën:

- "Pse po qan?" Fatimja iu përgjigj:

- "O i Dërguari i Allahut! Shoh që të është zbehur lëkura e rrobat të qenkan vjetëruar!"

IDërguari i Allahut tha:

- "Mos qaj, bija ime! Allahu e ka dërguar babanë tënd me një mision të atillë, që ai do të arrijë në çdo familje, në çdo fushë, në çdo fshat, në çdo qytet dhe në çdo kontinent ku vjen nata. Prej kësaj kauze ata njerëz ose do të besojnë dhe do të lartësohen, ose do të mohojnë dhe do të bëjnë një jetë prej të poshtëruarish."<sup>2</sup>

Një prej sahabëve, Temim ed-Dariu na tregon: "Unë e kam parë vetë me sytë e mi, te të afërmit, se si ata që besuan u lartësuan, dhe ata që nuk besuan u poshtëruan. Të gjithë ata që u bënë myslimanë, Zoti i shpërbleu me shumë të mira e mirësi, duke i bërë ata njerëz më të nderuar e më të pushtetshëm në sytë e njerëzve. Kurse ata që këmbëngulën në mohim, mbetën ashtu, të përbuzur e të përçmuar nga të gjithë, duke jetuar të detyruar që të paguajnë taksën e xhizje-s përgjatë gjithë jetës."<sup>3</sup>

### **Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1" M. Jusuf Kandeheui Botim i KMSH**

1. Taberani, Mu'xhemu'l-Kebir 11/197 (11480).

2. El-Hindi, Kenzu'l-Ummal 1/506 (1448).

3. Ahmed bin Hanbel, Musned 4/103 (16998).

# NJOHURI

## *me karakter historik*

Sipas librit historiko-statistikor "Shqipëria më 1927" e T. Selenicës, kemi të dhëna shumë interesante që do të plotësojnë një tablo të historikut të Islamit në Shqipëri dhe do të ndriçojnë akoma më tepër punimet dhe aktet e Kongresit të vitit 1923.

Ja mes të tjerave se çfarë shkruhet në të:

- Populli shqiptar nga pikëpamja fetare ndahet në tre besime: mysliman, ortodoks dhe katolik. Shumica e popullit tonë është mysliman, dhe pjesa tjetër, e ndarë në ortodoks e katolikë dhe që janë të krishterë. Por ndarja e bijve të një kombi dhe të një gjaku në tre besime nuk ka cenuar aspak dashurinë vëllazërore të tyre dhe bashkimin kombëtar ashtu sikundër dhe shteti nuk ka fe zyrtare. Të gjitha besimet në vendin tonë janë të nderuara dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre është e siguar.

Feja në shtetin tonë, nuk mund të formojë pengesa juridike dhe besimet nuk mund të përdoren për qëllime politike. Sipas regjistrimit të bërë në vitin 1922 figuron se popullsia në Shqipëri e ndarë sipas besimeve është:

<b>Myslimanë</b>	<b>562,010</b>	<b>68.8%</b>
<b>Ortodoksë</b>	<b>16,9003</b>	<b>20.7%</b>
<b>Katolikë</b>	<b>85,603</b>	<b>10.5%</b>
<b>Popullsia</b>	<b>816,707 veta</b>	

Duke u nisur nga rregullsia matematike rezulton se përqindja gjithmonë është në lëvizje me kalimin e viteve dhe se favorizohet gjithmonë ai që ka shumicën e popullatës.

Kongresi i Parë Mysliman Shqiptar u mbajt në Tiranë nga data 24 shkurt 1923 deri më 12 mars 1923.

Në këtë kongres morën pjesë delegatë nga e gjithë Shqipëria, duke shpallur kështu mëvetësinë e Xhamisë

Myslimane Shqiptare.

Për rregullimin në të ardhmen të aktivitetit të Komunitetit Mysliman, u vendos që të formoheshin dy këshilla: Këshilli i Naltë i Sheriatit si dhe Këshilli i Xhemaatit. U formua kështu Këshilli i Naltë i Sheriatit prej 4 vetash me qendër në kryeqytet të zgjedhur po nga Kongresi.

Kryetari i Këshillit të Naltë të Sheriatit përfaqësonte Komunitetin Mysliman në Shqipëri me titull Myfti i Përgjithshëm.

Njëri nga 4 anëtarët e zgjedhur të Këshillit të Naltë dekretohej nga Kryetari i Republikës për kryemyfti ndërsa dy të tjerët ishin anëtarë.

Dy anëtarët dhe ndihmës/anëtari dekretoheshin nga Kryetari i Këshillit të Naltë të Sheriatit.

### Detyra e Këshillit të Naltë të Sheriatit

- Të sigurojë njësinë dhe barazinë ndërmjet myslimanëve, si dhe të nxjerri në pah shpirtin dhe qëllimin e Sheriatit, duke zhdukur të gjitha besëtytnitë dhe zakonet e këqija të cilat nuk kanë të bëjnë fare me Islamin. Të ngrrejë institucionet fetare për nxjerrjen e Vaizëve, Myftive, Myderrizëve, Teologëve, Imamëve dhe Hatibëve.

- Të përmirësojë punën në Medrese, sipas principeve dhe metodave moderne.

- Të ngrrejë streha vorfënore.

- Të studiojë dhe të shqyrtojë raportet e paraqitura nga Drejtoria e përgjithshme e Vakfit, të kontrollojë buxhetin e përgjithshëm përgatitur nga drejtoria e financës, të emërojë dhe të shkarkojë sipas rregullave të aprovuara të gjithë nëpunësit e Sherisë dhe të vakfeve, të shqyrtojë dhe të zgjidhi të gjitha aktvendimet dhe fetvatë, të përgatisë rregulloren e



administrimit të përgjithshëm, të sigurojë botimin e një reviste të paktën njëherë në muaj, të botojë dhe të përkthejë librat e nevojshëm për shtimin e kulturës islame, të përkujdeset për të ngritur më lart mësimin e besimit, si dhe të përgatiten në gjuhën shqipe hytбет dhe predikimet që mbahen para xhematit.

Këshilli i Naltë i Sheriatit nëpër prefektura dhe nënprefektura përfaqësohej prej Myftinjve ose Naibëve (zëvendësve) nën kryesinë e të cilëve vepron Këshilli qendror i Xhematit me anëtarë sipas popullatës.

Myftinjtë dhe Naibët për problemet e sheriatit bëjnë dhe janë në marrëveshje me Myftinitë e përgjithshme.

Anëtarët e këshillave të Xhemateve zgjidheshin çdo katër vjet. Këshillat e xhematëve të katundeve formoheshin prej 5 anëtarësh dhe merreshin e lidheshin me këshillat e nënprefekturave, prefekturave dhe këto me Këshillin e Lartë të Sheriatit.

Si çdo komunitet tjetër dhe ai mysliman ka pasuritë e tij që janë vakëfet, të cilat administroheshin nga Drejtori i Përgjithshëm, që zgjidhej nga kongresi dhe dekretohej prej Këshillit të Naltë të Sheriatit, gjithashtu ishte anëtar i këtij këshilli. Ai zgjidhej një herë në katër vjet prej kongresit.

Këshilli i Naltë zgjidhej nga Kongresi Mysliman, që zhvillonte punimet në çdo katër vjet. Zgjedhjet për në kongres bëheshin konform rregullores së posaçme.

Në 15.000 frymë zgjidhej një delegat. Nuk mund të zgjidhej si delegat ai që s'ka mbushur 25 vjeç, që është i dënuar për çështje ordinere dhe ai pa arsim përkatës.

Detyrat e Kongresit ishin:

Shqyrtimi i buxhetit, aprovimi i rregulloreve, kontrolli i veprimeve të Këshillit të Lartë të Sheriatit dhe të Drejtorisë së përgjithshme të Vakfit. Këshilli i Naltë i Sheriatit thërret Kongresin në mbledhje të jashtëzakonshme, në rast se këshilli kontrollues e sheh të nevojshme.

#### **Lista e delegatëve që morën pjesë në Kongresin e 24 shkurtit 1923:**

1. Nga prefektura e Tiranës		z. Mytesim
Këlliçi		
2.- // -	e Shijakut	z. Ahmet Rustemi
3.- // -	e Krujës	z. Mehmet Pengili
4.- // -	e Durrësit	z. Hafiz Ali Korça
5.- // -	e Kavajës	z. Haxhi Jusuf
Kazazi		
6.- // -	e Shkodrës	z. Halit Rroji
7.- // -	e Pukës	z. Xhemal Najpi
8.- // -	e Lezhës	z. Mehmet R. Maçi
9.- // -	e Shkodrës	z. Hafiz Sabri
Bushati		
10.- // -	e Elbasanit	z. Muharrem
Mullahu		



11.- // - e Peqinit z. Shyqyri Myftiu  
 12.- // - e Gramshit z. Salim Luniku  
 13.- // - e Librazhdit z. Musa Haxhi Aliu  
 14.- // - e Beratit z. Qerim Fuga  
 15.- // - e Lushnjës z. Sheh Ibrahim

Karburnara  
 16.- // - e Skraparit z. Dervish Aliu  
 17.- // - e Mallakastrës z. Qerim Buzmadhi  
 - Tato  
 18.- // - e Fierit z. Abdurrahman

Fehmiu  
 19.- // - e Vlorës z. Ibrahim Xhindi  
 20.- // - e Kurveleshit z. Ali Koka  
 21.- // - e Gjirokastrës z. Reshat Kokalari  
 22.- // - e Tepelenës z. Abdurrahim

Tepelena  
 23.- // - e Përmetit z. Salih Hamzaj  
 24.- // - e Libohovës z. Ali Galibi  
 25.- // - e Delvinës z. Vehbi Kallapoli  
 26.- // - e Korçës z. Shaqir Hoxha  
 27.- // - e Bilishtit z. Emin Menkulasi  
 28.- // - e Kolonjës z. Halim Gostivari  
 29.- // - e Pogradecit z. Banush Hamdiu  
 30.- // - e Dibrës z. Vehbi Dibra  
 31.- // - e Zërqanit z. Salih Vuçiterni  
 32.- // - e Matit z. Jakup Sabri  
 33.- // - e Kosovës z. Qamil Bala  
 34.- // - e Hasit z. Rasim Sulejmani  
 35.- // - e Lumës z. Sheh Xhemaliu

36.- // - e Lushoviqit z. Ihsan Lushoviqi

### 1.Përfaqësuesi i Qeverisë z. Qerim Çelo

Kongresi Mysliman Shqiptar përfundoi më datën 12 mars 1923 dhe zgjodhi Këshillin e Naltë të Sheriatit si më poshtë:

1- Vehbi Dibra	30 vota (kryetar)
2- Hafiz Ali Korça	29 vota
3- Vejsel Nailiu	27 vota

### Nga tarikatet

4- Haxhi Adem Baba	28 vota
5- Sheh Ibrahim Karburnara	26 vota

### Nga civilat

6- Qamil Bala	28 vota
7- Reshat Kokalari	20 vota

Drejtori i Përgjithshëm i Vakfeve u zgjodh z. Salih Vuçiterni 32 me vota. Gjithashtu ky kongres aprovoi dhe:

- Rregulloren mbi zgjedhjet në forumet e Komunitetit Mysliman Shqiptar.
- Projekt Statutin e Komunitetit Mysliman Shqiptar.
- Rregulloren mbi organizimin e vakëfeve Myslimane në Shqipëri.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Nasuf T. Dizdari, Njohuri me karakter historik, gazeta "Drita Islame", nr. 4 (135), shkurt-mars 1998, f. 1-3.

*Një lutje e Profetit  
tonë A.S*



Duaja, lutja është një formë adhurimi, thelb i robërisë, emri i kthimit dhe drejtimit te Zoti. Në një vend ku përmendet adhurimi, është e pamundur të mos flitet për duatë. Në fund të fundit, Allahu (xh.sh) a nuk tha: "Çfarë rëndësie keni nëse nuk keni lutje!" (Furkan, 25/77)? Prandaj, kur shikojmë jetën e Profetit, shohim se ai ishte njeri i lutjes:

Ibn Abbasi shpjegon se si lutej Pejgamberi, i cili tha: "Nuk ka asgjë më të nderuar tek Allahu se duaja."<sup>1</sup>

"E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s) duke lexuar lutjen e mëposhtme kur e përfundoi namazin e natës:

"O Allah, të kërkoj mëshirën Tënde, që me të të më udhëzosh zemrën, ta mbledhësh çështjen time dhe të bashkohsh. ajo që është shpërndarë nga punët e mia, korrigo me të atë që më është fshehur, ngri me të atë që më është e dukshme, pastro me të veprimet e mia dhe më frymëzo me të me atë që përmban udhëzimin tim. dhe më ruaj me të nga ajo që kërkoj mbrojtje dhe më mbro me të nga çdo e keqe.

O Allah më jep besim dhe siguri pas së cilës nuk ka mosbesim dhe mëshirë, me të cilën mund të arrij nivelin e lartë të bujarisë Tënde në dynja dhe në ahiret. O Allah, të kërkoj sukses [në atë që jep dhe lehtësim] në gjykim, në pozitat e shehidëve, në furnizim të të shpëtuarve dhe në ndihmë kundër armiqve.

O Allah, të lë Ty nevojën time, veprat e mia janë të dobëta, kam nevojë për mëshirën Tënde, andaj të lus Ty, o vendosës i çështjeve dhe o Shërues i gjokseve, pasi më ndanë nga dënimi i Xhehennemit flakërues dhe nga kërkimi i shkatërrimit dhe nga sprova e varreve.

O Allah, çfarëdo gjëje për të cilën mendimi im ka dështuar, dhe qëllimi im nuk e ka arritur atë, dhe kërkesa ime nuk e ka përfshirë atë, për të mirën që i ke premtuar dikujt prej krijimit tënd, ose çfarëdo të mirë që do t'i japësh dikujt nga robërit e Tu, me të vërtetë, e kërkoj prej Teje dhe e kërkoj prej Teje, me mëshirën Tënde, o Zot i botëve.

O Allah, zotërues i litarit të fortë dhe çështjes së udhëzuar, të kërkoj siguri në ditën e kërcënimit dhe Xhennet në ditën e pavdekësisë së bashku me dëshmitarët, të afruar, të cilët përkulen dhe bëjnë sexhde, që përmbushin Besëlidhjet, Ti je i Mëshirshëm, i Dashur dhe me të vërtetë, Ti bën atë që dëshiron.

O Allah, na bëj udhërrëfyes të udhëzuar dhe jo udhërrëfyes të devijuar, aleat të miqve të Tu, armik të armiqve të Tu. Ne i duam për shkak të dashurisë Tënde ata që të duan Ty dhe i urrejmë për shkak të armiqësisë Tënde ata që të kundërshtojnë Ty.

O Allah, kjo është lutja (për të cilën ne jemi të aftë), dhe Ty të takon të përgjigjesh, dhe kjo është përpjekja (që ne jemi të aftë) dhe te Ti është mbështetja.

O Allah, më cakto një dritë në zemrën time, një dritë në varrin tim, dhe një dritë para meje, dhe dritë pas meje, dhe dritë në të djathtën time, dhe dritë në të majtë, dhe dritë mbi mua dhe dritë poshtë meje, dhe dritë në dëgjimin tim, dhe dritë në shikimin tim, dhe dritë në flokët e mi, dhe dritë në lëkurën time, dhe dritë në mishin tim, dhe dritë në gjakun tim dhe dritë në kockat e mia.

O Allah, ma madhëro dritën dhe më cakto dritë. Lavdi i takon Atij që mbart Lavdinë dhe jep me të. Lavdia i takon Atij të Cilit nuk i takon askujt tjetër madhërimi përveç Atij, Zotëruesit të Nderit dhe Bujarive, Lavdia i takon Zotëruesit të Lavdisë dhe Bujarisë, Lavdia i takon Zotëruesit të Madhërisë dhe Nderit."<sup>2</sup>

Sulltani i të dërguarve (a.s.) i lutej Allahut çdo ditë, pa shkëputur, njëqind herë, duke kërkuar falje dhe mëshirë, dhe megjithëse mëkati nuk ishte asnjëherë prirje e tij, ai nuk u largua nga kthimi tek Allahu as edhe një ditë. Sepse një nga detyrat e tij më të rëndësishme ishte të ishte një shembull i mirë për njerëzit. Ky është rasti në botën e sotme. Domethënë, ata që dinë japin shembull për ata që nuk dinë, i udhëzojnë dhe i mësojnë. Në fund të fundit, njerëzit në përgjithësi janë krijuar nevojtarë.

Ne kemi nevojë për ndihmën e të tjerëve derisa të arrijmë një nivel të caktuar në çdo punë. Këtu, i Dërguari i Allahut i udhëzoi shokët e tij në kohën e tij dhe të gjithë muslimanët që do të vinin deri në Ditën e Gjykitimit të mbanin qëndrimin që duhej të mbanin para Allahut Teala. Ai tha: "O njerëz! Unë pendohem tek Allahu njëqind herë në ditë dhe kërkoj falje. Pendohuni tek Ai dhe kërkoni falje."

Ai ka thurur çdo kornizë të jetës së tij me lutje të qëndisura. Këto lutje janë të përfshira në librat me përmbledhje të lutjeve. Ajo që duhet të bëjmë është t'i lexojmë ato dhe kështu të fitojmë kënaqësinë e Zotit tonë dhe Pejgamberit tonë.

**Përktheu: Haki Sahitaj**

<sup>1</sup> Tirmidhî, Daavat, 1; Ibn Maxhe, Dua, 1.

<sup>2</sup> Tirmidhî, Daavât 30.

# Imperativi islamik për bashkim e vllaznim

Me anë të këtij artikulli të shkurtën ka me u sqarue se si Islami shtyn me insistim besnikët e tij për me u bashkue e për me u vllaznue njëri me tjetrin.

Parimet dhe urdhënesat e tij, si ka me u pa këtu poshtë, zotnojnë një trajtë imperative për sa i përket problemit të bashkimit kombëtar të një populli. Ato e bëjnë detyrë të domosdoshme të dashurit e tjetrit si vetveten, të nderuemit e shëshoqit, të mbrojturit e jetës së vëllait tand të fesë e në kombësi dhe mos shkeljen e të drejtave të tjetrit.

Versetet e Kuranit të Shenjtë, që flasin tekstualisht mbi bashkimin e mbi solidaritetin, që na nxisin për me i dhanë dorën njëri-tjetrit dhe që na shtynë për me pasë gjithmonë një bashkim të ngulët e permanent, që dënojnë ndarjen ndër partina, rryma, pikëpamje e idena të ndryshme, janë të shumtë. Ata jo vetëm që e përfillin si një mbëhi të bashkuesit e besnikëve, por disa prej tyre flasin gjithashtu tekstualisht edhe për një propagandë bashkuese që detyrohet mbi të gjithë muslimanët e dijshtëm e të kulturuar. Ata flasin gjithandej se pasojat e këqija që sjellin me vete përçarjett e dasinat, të cilat shkaktojnë vlla-vrasje dhe anarki e kështu i japin, shpeshherë, fund ekzistencës së një shoqnie a të një kombi.

Për të kuptuar tash sa u tha këtu sipër, le të kthehemi në Kur'an të Shenjtë, Librin e Naltë të Islamit, i cili asht edhe themeli më i fortë i shoqnisë njerëzore. Versetet që vijnë e që i përkasin kaptinës së Familjes s'Imranit shprehin tekstualisht mbëhinë e bashkimit e të solidaritësisë që nevojiten për ekzistencën e një kombi:

“O ju që besoni! Kujdesohuni për me krye plotësisht detyrën tuaj ndaj Zotit ashtu sikundër Ai e meriton dhe mos vdisni veçse duke qenë muslimanë”.

“Dhe kapuni, që të gjithë, fortësisht për besën që i keni dhënë Perëndisë dhe mos u përçani ndër partina dhe përmendeni përkrahjen që Perëndia ju ka ba në një kohë që ju ishit armiq dhe Ai bashkoi midis zemrave tuaja, në mënyrë që ju, me përkrahjen e Tij,

u bëtë vëllezër. (Përmendeni) mbasëndej edhe atë kohë në të cilën ju gjendeshit mu në buzë të një grope zjarri dhe Ai ju shtpëtoi prej saj. Në këtë mënyrë, Zoti ju sqaron komunikimet e Tij që ju të ndiqni Udhën e Drejtë”.

Në tekstin origjinal, në gjuhën arabisht, takojmë në termin Habi që ndodhet në këtë verset. Habi, në kuptimin natyral, do të thotë litar. Në kuptimin figurativ tregon një lidhje a një mjet bashkimi, një lidhje dashurie e vllaznimit, një besë ose një shtrëngim radhësh a bashkërendim rreshtash. Me anë të kësaj besë të dhanun Perëndisë, secili prej bahet përgjegjës për mirëqenien dhe ekzistencën e tjetrit e, si pasojë, për mirëqenien dhe ekzistencën e mbarë kombit të përbamë prej nesh. Le ta mbajmë pra besën, po e mbajtëm këtë besë, kemi dashtun sho-shoqin dhe po të duam sho-shoqin kemi dashtun edhe kombin.

Këtij verseti i janë dhënë edhe kuptime të tjerë me shumicë prej komentatorësh të ndryshëm. Domethënia e terminologjisë “Habli-Lah” që ekziston në këtë verset e që i dhamë kuptimin këtu sipër me frazën Besa e Perëndisë, forcohet edhe prej traditave profetike. Simbas njanës, tregohet se Profeti i Shenjtë të ketë urdhëruar se Libri i Zotit asht besa e Zotit dhe se, simbas tjetrës, Kur'ani i Shenjtë, asht besa e pathyeshme e Zotit.

Historia na njofton se para ardhjes së Profetit të Shenjtë, arabët ndodheshin në një gjendje të vazhdueshme lufte kundrejt njëri-tjetrit. Kjo gjendje, kërcënonte me rrënue të gjithë vendin. Ata ishin të përçamë njëri prej tjetrit. Verseti i shenjtë që u përmend më sipër e dënon këtë përçarje ashtu sikundër dënon çdo përçarje e vëllavrasje që rastësisht rrethanat mund të kenë futun ndër ata kombe që i besojnë Fesë Islame. Shkurt, verseti dënon çdo situatë anarkie e përçarjeje, e cila kërcënon zhdukjen e një kombi.

Nga ana tjetër verseri urdhëron me u lidh njëri me tjetrin dhe me i shijue bashkërisht të mirat e të



këqijat, që i ndodhin Atdheut. Verseti mandej implikon se Perëndia i Madhnueshëm ka me i kurërozue padyshim me sukses dhe ka me i bekua plotësisht përpjekjet që njerëzit bëjnë për bashkim e solidarësi.

Përveç këtij verseti kemi edhe një tjetër që na shtyn për me veprue në të mirë të njani tjetrit dhe të kombit:

“Dhe prej jush le të jetë një pjesë që të grishi në të mirën duke urdhëruar çka është e drejtë dhe duke ndaluar çfarë është e gabuar. Kjo pjesë njerëzish janë vetë ata që kanë për të shpëtuar”.

Ky verset i shenjtë drejton, në fakt, besnikët e kulturuam e të dijshtëm se pikësynimi i këshillave të tyne duhet me qenë të predikuesit e parimeve të Islamit, të cilët udhëheqin me siguri për në harmoni, drejtqëndrim dhe interdipendencë shoqnore dhe nuk i lanë anëtarët që përbëjnë një komb për me u gabue prej propandave të huaja.

Një verset i tretë mandej urdhënon që të mos iu përngajmë atyre që u ndanë prej sho-shoqit, të cilëve u takuan katastrofa e fatkeqësina. Verseti asht si vijon:

“Dhe mos u bani si ata që u ndanë dhe ranë në konflikt me sho-shoqin mbasi iu patën ardh argumente të qarta. Këta janë asish që ka me i prekë një mundim i madh”.

Tash s’na mbetet me thanë se veç Zoti na ruejtë prej këti mundimi që ka destinua e premtue Perëndia për njerëzit që përçahen njanit prej tjetrit.

Shkurt, versetet e sipërme na urdhërojnë me u bashkue dhe me qenë solidarë kundrejt njani tjetrit. Ata na cytin që nevojat e përbashkëta dhe nevojat e veçanta t’i plotësojmë me udhë të përbashkëta dhe nevojat e veçanta ose të ndryshme t’i sigurojmë me shkëmbimin e shërbimeve reciproke. Këtë veprim të tillë e pëlqen edhe i Madhi Zot, i Cili asht dhurues dhe bekues i pamasë i krijesave të Tij, po të jetë se këto i binden plotësisht urdhrave të Tij dhe veprojnë simbas tyre.

**“Kultura Islame”, Nr. 5-6, Shkurt 1994.**

# HAXHI VEHBI DIBRA

## *klerik dhe patriot i devotshëm*

Vehbi Dibra (Agolli) lindi në një familje me tradita, në Dibër të Madhe, në vitin 1867 dhe la rahmet në Tiranë më 1937.

Gjithë vepra e Vehbi Efendiut mbetet si një mal në fushën e diturisë dhe kulturës sonë teologjike. Të paharruara e frymëzuese mbeten gjithmonë para nesh vetitë e tij të larta e njerëzore: thjeshtësia, ndershmëria, fisnikëria shpirtërore, dashuria për të renë e për të rinjtë, të cilëve u jepte zemër që po të kishin një shkëndijë, të ndiznin zjarr. Kemi besim se brezat e ardhshëm, në vazhdimësi të mësimëve të fesë do të studiojnë gjithnjë e më thellë veprën e shquar të Vehbi Dibrës me mirënjohje dhe nderim të thellë.

Ishte mesatar për nga gjatësia e trupit, pak si i

thatë me një palë sy të zinj ku shkëlqenin mendja dhe zgjuarsia e tij, ai me një bisedë që bënte, të bënte për vete, kishte besim dhe fjalët i kishte të pakta, por kurdoherë me vend.

Vehbi Dibra akoma në moshën e fëmijërisë shquhej për një zgjuarsia dhe mendjemprehtësi të rrallë. Ai dallohej midis moshatarëve për zellin e tij të madh për të mësuar. Mësimet e para i mori në vendlindje dhe ato të larta jashtë vendit (në Stamboll) për teologji.

Ai jetoi në një kohë kur akoma ishte e freskët Lidhja e Prizrenit. Ai u frymëzua nga libri "Dhe shkronja" e Sami Frashërit. Qyteti i tij, Dibra e Sipërme, aty nga viti 1900 përfshinte 3 fshatra dhe nuk ishte më pak e dëgjuar se qytetet e tjerë si: Shkupi, Prishtina, Tirana,



Korça e Preveza, me një popullsi prej 136.100 banorë.

Mbas vitit 1880, monarkitë fqinje, si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia kërcënonin ekzistencën e shqiptarëve si komb, për të copëtuar trojet e tij të banuara nga shqiptarët. Pikërisht, Vehbi Dibra, duke qenë i ngarkuar me detyrën e Myftiut të Dibrës, i liste popullit se nderi i atdheut nuk mbrohet vetëm me lutje por edhe me përpjekje dhe sakrificë.

Vehbi Dibra ishte për bashkimin e kombit shqiptar dhe ishte luftëtar i zjarrtë për hapjen e shkollës shqipe me alfabetin e Manastirit, edhe kjo do të arrihet vetëm me kryengritjen e përgjithshme të armatosur popullore. Dhe pikërisht për këtë ai thirri Kongresin e Dibrës (Korrik 1909). Në këtë Kongres morën pjesë 36 delegatë nga të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët si: nga Kosova, Ismail Pashaj, Riza Beu, Rexhep Hoxha Myftiu i Dibrës (vëllai i Vehbi Agollit), nga Elbasani ishin delegatë Aqif Pashë Elbasani, Dervish Beu, Myderriz Ali Efendiu etj. Fillimisht, Kongresi zgjodhi për kryetar të tij, Vehbi Dibrën dhe sekretar: Halit Gjirokastritin dhe Islam Selanikun. Vehbi Dibra mbajti një fjalim të zjarrtë teologjik, e filozofik, falë kulturës së gjerë që kishte dhe si orator i mirëfilltë. Në historinë e Shqipërisë, Vëllimi i II, Tiranë 1984, fillon devijimi, qoftë edhe pa dashje, që e konsideron këtë Kongres si xhonturk, gjë që nuk është e vërtetë dhe s'i përgjigjet realitetit! Këtë e bazojmë në diskutimet e delegatëve, si dhe në kujtimet e tyre të lëna me shkrim si, Hafiz Ali Korçës, të Kenan Manastirliut etj. që e hedhin poshtë këtë vlerësim që i bën Historia e Shqipërisë. Po t'i referohemi të vërtetës historike, tonin këtij Kongresi ia dhanë shqiptarët, siç pasqyrohet nga vendimet që mori: *-Hapja e shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe. -Ndarja e shkollës nga kisha dhe xhamia. -Zhvillimi i ceremonive fetare në gjuhën shqipe. -Njohja e zakoneve nga pushteti në gjuhën shqipe dhe vendosja e rregullit dhe sistemit në ushtri.*

Të gjashtë seancat e Kongresit u kthyen në luftë të ashpër dhe kjo u duk në fjalimet e Vehbi Dibrës dhe në fjalimet e një pjese nga delegatët si i: Abdyl Ypit, Rexhat Voka, Haxhi Ali Elbasani etj. Pa mbushur akoma dy vjet nga mbyllja e punimeve të Kongresit,

Midis delegatëve për shpalljen e Pavarësisë (28 Nëntor 1912) u nisën në Vlorë, Vehbi Dibra bashkë me Hafiz Sherif Langun. I

takon Vehbi Efendiut të nxjerrë fetvanë për zhgabën e zezë dy krenare në mes fushës së kuqe të flamurit. Në kujdesin e Vlorës 28.XI.1912, ndër vendimet e rëndësishme, ishte edhe ai i krijimit të Senatit (Pleqësisë) prej 18 anëtarësh, Kryetar i së cilës u zgjodh Vehbi Dibra, kurse Ismail Qemali u zgjodh kryetar i qeverisë së përkohshme.

Fetvaja për zhgabën dykrenare qëndronte - tha Vehbi Dibra - në petkat që ka veshur myslimani nëse ndodhet një figurë e vogël e gjësë së gjallë, organet e së cilës prej së largu nuk duken a ka ndonjë pëlqim? Përgjigja: "Nuk është e lehtë". Vehbi Dibra për çdo veprim mbështeti Ismail Qemalin. Kur u nis në krye të delegacionit, Ismail Qemali, la në krye të Qeverisë së Përkohshme Vehbi Agollin (Dibrën), i cili nga data 30 mars 1913, për dy muaj rresht kryesoi qeverinë në mbledhjet e saj, madje përballoi lakmitë serbe e malazeze dhe organizoi kryengritje shqiptare në mbrojtje të trojeve, që udhëhiqeshin nga Bajram Curri, Elez Isufi, Hasan Prishtina etj. dhe se mbajtja e tërësisë tokësore mund të bëhet vetëm me armë dhe se kryengritësit patën mbështetjen e qeverisë së përkohshme dhe veçanërisht të Vehbi Dibrës. Këtu le të ndalemi dhe të përmendim fjalët e naçallnikut N. Cirkoveç: "Kryengritja pa ndonjë (fjalë e pakuptueshme) ka mundur ta përgatisë vetë Vehbi Efendiu, nën urdhrin e të cilit janë të gatshëm të ngrihen të gjithë të uriturit! Ai është dhe Shejhul Islami i Shqipërisë. Kryengritja u përhap nga muaji Shtator 1913, por mjerisht kish mungesa në municione dhe armë. (Fjali e pakuptueshme)." Në një letër që vjen nga fronti thuhet: "...Në rast se dërgoni fuqi dhe armë, sukcesi është i sigurt." Edhe këtu nxjerr krye tradhtia e Esatit, ai në vend që të ndihmonte kryengritësit, përkundrazi i pengonte. Serbët ushtronin terror të paparë. Në lumin Drin nuk shikoje gjë, përveç trupa të pajetë fëmijësh, grash e pleqsh si dhe hi.

Edith Durham këtë terror e përcakton në këtë mënyrë: "Fuqitë e Mëdha po kryejnë një veprim kriminal duke e shtyrë ardhjen e komisionit të caktimit të kufijve." Nga ana e tij, Vehbi Dibra e çmonte mjaft rendin, mungesa e të cilit - thoshte ai - sjell anarkinë dhe situata të papëlqyera me të cilat Shqipëria është ndeshur mjaft herë (dhe kjo ishte arsyeja që mjaft atdhetarë idealistë preferonin më shumë një shtet ateist si ai i A. Zogut, i cili pati një administratë të



rregullt, e cila diti të përfitojë nga Perëndimi). Vlen të theksohet se pas vitit 1925, Vehbi Dibra i përkushtohet tërësisht punëve të Komunitetit Mysliman dhe u shkëput nga veprimtaria e drejtpërdrejtë politike, sido që deri në frymën e fundit ai pati për moto Fe - At dhe, këtë binom.

Interesante është përgjigjja që marrin shumë analistë grekë apo serbë kur pyesin ballkanasit se çfarë jeni? Përgjigja e tyre është: "jemi të krishterë", ndërsa kur pyesin shqiptarët, myslimanë apo të krishterë përgjigja është: "jemi Shqiptarë"; përgjigje kjo, që është mjaft kuptimplotë.

Justin Godarti, studiues francez ka thënë: "Shqiptarët e të gjitha besimeve kanë qenë unanimesë dhe kanë luftuar krah për krah. Në Shqipëri, patriotizmi është shqiptar. Kur ai është besimtar, ndez zjarrin dhe i nënshtrohet nacionalitetit dhe në të njëjtën kohë është gati të ndezë zjarr të ri që t'u shërbejë interesave të Shqiptarëve."

Shqipëria ka nxjerrë burra që i kanë bërë nder vendit të tyre si; Mehmed Basha Dukagjini, që ka qenë poet lirik, Arkitekt Sinani, që ndërtoi xhaminë e madhe të Stambollit dhe që mbiemërohej "Mikelanxhelo i Lindjes", profesorin e shquar Hasan Tahsini Filatin, rektorin e parë të Universitetit të Stambollit, inspektorin e vilajetit shkodranin Daut Boriçi, si dhe shkencëtarin enciklopedist dhe ideologun Sami Frashëri, pa numëruar një plejadë të tërë të Rilindjes Kombëtare të Pavarësisë si: Haxhi Zeka, Hoxhë Voka, Hoxhë Moglica, Haxhi Vehbi Dibra, Hoxhë Kadriu, Sheh Suleç, Hafiz Ali Korça, Hafiz Malje Tanushi, Hafiz Dauti, Hafiz Lila, Hafiz Veledin Banku, Hoxhë Kurt Balla, Hafiz Sherif Langu etj...

Figura patriotësh kanë pasur edhe fetë e tjera si: Preng Doçi, Patër Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, martiri shkodran At Stefan Gjeçovi, i vrarë nga malazezët, politikani dhe poeti i shquar Fan S. Noli, i cili u dorëzua si prift vetëm e vetëm për të shpëtuar Shqipërinë, Papa Kristo Negovani, i vrarë nga grekët, dëshmori i kombit etj...

Më 1 Mars 1918 ndodhi një akt i pazakontë, disa të krishterë nga Shkodra hodhën parulla ofenduese ndaj myslimanëve si: "Poshtë xhamija", "Poshtë Mevludi", por akoma më e keqja ishte therja e derrit në derën e xhamisë. Kjo u prit me indinjatë të thellë nga myslimanët, por kryemyftiu Vehbi Efendi u bëri takime e bëri bisedime me klerikë të

ndryshëm (të krishterë) dhe në mënyrë demonstrative tha se këto veprime nuk i sjellin ndonjë dëm bashkimit të popullit dhe se 4 apo 5 herra nuk përfaqësojnë komunitetin e krishterë dhe nga ana tjetër iu drejtoi një notë proteste autoriteteve Austro-Hungareze, pastaj bëri përpjekje të shumta për të qetësuar gjendjen.

Vehbi Dibra qysh në Marsin e vitit 1920 i drejtohej zyrave të myftinive me një qarkore, tash e tutje të mos përdoren vulat turqisht, as në gjuhën turke në aktet zyrtare, por të mbaroni sa më parë një vulë me shqiponjë, duke futur kështu në institucionet fetare simbolin e flamurit tonë kombëtar.

Në kongresin e parë të Komunitetit Mysliman që u mbajt në Tiranë më 12 Mars 1923, u morën vendime të rëndësishme. Ky kongres zgjodhi Vehbi Dibrën si Kryetar të Komunitetit Mysliman Shqiptar, gjithashtu shpalli autoqefalinë e institucioneve të fesë islame në Shqipëri. Me këtë rast u bënë vizita në Komunitetin Mysliman nga ai Orthodoxos, kështu në emër të Këshillit të Naltë At Vasil Marko, erdhën Peshkopi Jetothos, nga prefekti në emër të qeverisë etj...

Vehbi Dibra në ditët e shenjta të myslimanëve mbante vazë në xhaminë e vjetër si në ditët e Ramazanit apo të Mevludit, të cilët i shërbenin jo vetëm besimtarëve, por dhe vetë klerikëve me thëniet nga Kurani Kerim, i cili me gjithë se ishte përkthyer në 140 gjuhë të botës, në gjuhën shqipe akoma nuk ishte përkthyer, megjithëse specialistët në atë periudhë ishin me shumicë. Shumë artikuj të Vehbi Dibrës janë botuar në revistën "Zani i Naltë", janë aktualë dhe edhe për kohën e sotme. Ato kanë përfshirë ç'urdhëron Kurani Kerim. Kurani gjatë shekujve nuk ka ndryshuar qoftë edhe një germë të vetme dhe është aktual edhe për kohën e sotme me njohuritë shkencore që jep. "Kërkoje diturinë edhe në Kinë", injorancën nuk mund ta justifikojmë as me pleqërinë tonë, as me mungesën e shkollave në atdheun tonë, se jemi urdhëruar të shkojmë edhe në vendet më të largëta për studime, qofshin këto vende edhe jo myslimane.

Me këtë rast i drejtohem Hazreti Muhamedit a.s. që urdhëron e thotë: *"Për tri gjëra vazhdon të shpërblehet i vdekuri: kur ka lënë pasuri për mirëbërje, ka lënë libra që përfitojnë nga leximi i tyre njerëzia dhe ka lënë fëmijë që luten për të."*

# Efektet negative të egoizmit në familje

Mendjemadhësia dhe egoizmi janë dy faktorë të cilët ndikojnë negativisht në marrëdhënien mes bashkëshortëve, mes fëmijëve dhe prindërve duke kërcënuar lumturinë, harmoninë familjare dhe duke pakësuar dashurinë e respektin.

Egoizmi i lidhur ngushtë me mendjemadhësinë pengon bashkëveprimin në familje duke i bërë anëtarët e saj më të vetmuar. Në të kundërt të kësaj, në marrëdhëniet e shëndetshme bashkëshortore, partnerët mirëkuptohen dhe bashkëprojnë me njëri-tjetrin. Fëmijët mësojnë të nënvlerësojnë, të tallen, ofendojnë të tjerët nga prindërit egoistë dhe mendjemadhës. Në familjet ku mbizotëron mendjemadhësia dhe egoizmi rriten fëmijë problematikë përsa i përket komunikimit të shëndetshëm me shokët e klasës. Ato nuk kursehen të shpalosin të njëjtat sjellje egoiste edhe ndaj shokëve të tyre. Individë të cilët nuk arrijnë të mësojnë që në fëmijëri bashkëveprimin, dhembshurinë, mirësjelljen, vlerësimin e të tjerëve do të shfaqin vazhdimisht probleme në jetën profesionale kur të bëhen të pavarur. Njerëz të tillë në vend të shfrytëzimit pozitiv të motivimit të lindur nga gara me të tjerët preferojnë të cënojnë të drejtën e të tjerëve me mendimin se 'vetëm unë kam të drejtë të arrij suksesin'.

Persona të tillë të cilët shfaqin shenja të mendjemadhësisë dhe egoizmit ndryshe quhen narcistë dhe egoistë. Narcizmi shkakton të çara në marrëdhënien në çift dhe e bën normale sakrifikimin e njëres palë, duke ndërmarrë përsipër të gjitha punët. Ashtu siç shkruhet edhe në shumë histori mistike narcistët e duan aq shumë veten sa që në zemrën e tyre nuk ka vend për tjetërkënd. Narcistët do të kalojnë shumë mire me ju përsa kohë i

lavdëroni, duartrokisni, i lejoni të jenë të parët dhe nuk konkuroni me to.

Një njeri mendjemadh dhe egoist nuk respekton mendimin e të tjerëve, nuk mund të mirëkuptojë personin përballë duke u vendosur në vendin e tij, nuk të fal kur gabon dhe nuk arrin të bëjë shumë akte pozitive vetëm nëse është i detyruar. Në rast se i sugjeron respektin apo faljen e një gabimi ai të kthehet me fjalë si ' pse duhet ta respektoj unë, ai të më respektojë i pari, apo pse ta fal unë, ai më ka bërë këtë e atë.' Krahas kësaj, narcisti ka gjithmonë në gojë nënvlerësimin, kritikën, gjetjen e një të metë, thyerjen e zemrës etj. Egoisti nxjerr si argument vetëbesimin për të justifikuar sjelljen e tij. Po të shihet me vëmendje të gjitha këto sjellje të pahijshme të tyre lindin nga mungesa e vetëbesimit. Vetëbesimi ndryshon shumë nga të pëlqyerit e vetes dhe egoizmi. Vetëbesimi të motivon pozitivisht përballë vështirësive të jetës dhe pasqyron energji pozitive tek njeriu vetëbesues.

Çfarë mund të bëjmë për të shpëtuar familjet, marrëdhëniet tona nga e keqja e mendjemadhësisë dhe egoizmit?

Pikë së pari duhet të jemi të ndërgjegjësuar në lidhje me këtë çështje. Sjellje si: të kërkosh gjithmonë të drejtën tënde edhe në situata kur je gabim, të nënvlerësosh njerëzit e tjerë, të kërkosh të metat, të duket sikur e gjithë bota sillet rreth teje, të dëshirosh të jesh vazhdimisht i pari, të marrësh lavdërime të shpeshta e të tjera të ngjashme tregojnë mosarritjen e maturisë së duhur në zhvillimin personal.

Nëse narcizmi dhe egoizmi konsiderohen si një helm që vret marrëdhëniet ndërjetëzore atëherë duhet të gjejmë antihelmin e tij që është modestia. Kohëve të



fundit modestia shihet si një pëlqim apo pranim i çdo sjelljeje por ky është një konceptim i gabuar. Një njeri modest nuk është një njeri i përulur dhe i nënvlerësuar në të kundërt, modestia tek ai është një vlerë e shtuar që shton maturinë.

Në librin e tij 'Narcizmi , sëmundja e shekullit ' autori Prof. Dr. Jean M. Twenge sugjeron zhvillimin e ndjenjës së falenderimit si një kurë ndaj narcizmit. Fokusohuni tek falenderimi, falenderimi do t'ju ndihmojë të ndiheni të lumtur me ato që keni.

Një rrugë tjetër e të mbrojturit nga egoizmi dhe mendjemadhësia është t'i thuash vetes ' nuk duhet të jem perfekt, unë ekzistoj bashkë me gabimet e të metat e mia'. Nuk është e thënë të ndiheni më mirë se të tjerët për të qenë të kënaqur me veten tuaj.

Tani le të analizojmë dy shembuj konkretë, tek i pari le të kemi një bashkëshort i cili na do sepse jemi të përkryer dhe pa të meta dhe në rastin e dytë një njeri që na do ashtu siç jemi, bashkë me të metat tona. Cilí nga rastet e mësipërme është më njerëzor dhe më i dëshiruar? Padyshim që të gjithë do të zgjidhni rastin e dytë sepse të gjithë kemi nevojë të duhemi ashtu siç jemi, bashkë me të metat, gabimet tona. Nëse arrijmë ta bëjmë këtë atëherë nuk do të lodhemi duke luftuar me njëri-tjetrin për epërsi dhe superioritet.

Krahas kësaj ata të cilët jetojnë me mendimin 'mos i bëj tjetrit atë që nuk dëshiron të të bëhet ty' qëndrojnë larg sjelljeve egoiste. Përsa kohë do të qëndrojmë larg egjiozmit dhe narcizmit do të arrijmë shumë pozitivitet në marrëdhëniet bashkëshortore, familjare dhe shoqërore.

Me shpresën e të qenurit një njeri në mes njerëzve...



# Një rifreskim i Mjekësisë Profetike dhe bimore

Ndjekja e shembullit të Profetit Muhamed a.s. është përmendur dhe urdhëruar në Kur'anin Famëlartë si rruga më e mirë për besimtarët. Për pasojë, praktikat dhe këshillat e Profetit a.s. kanë qenë një burim i paçmuar i cili qëndron pas Kur'anit për nga vlera dhe rëndësia dhe mbi të cilat janë themeluar disa shkolla juridike që kanë shërbyer si udhërrëfyes për besimtarët në mbarë botën prej 1400 vitesh. Në një ajet kuranor thuhet: "Çka t'ju japë i Dërguari, atë merreni, e çka t'ju ndalojë përmbajuni dhe kini frikë Allahun" (Hashr, 7). Meqë shëndeti është një pjesë shumë e rëndësishme e jetës së njeriut, myslimanët përgjatë shekujve i kanë kushtuar një

vëmendje të madhe mësimave dhe praktikave të Profetit a.s. në lidhje me ruajtjen e shëndetit, parandalimit dhe kurimit të sëmundjeve.

Libri më i njohur mbi "Mjekësinë Profetike" është shkruar nga Ibn Kajjim el-Xheuzi (691-751h / 1293-1351), por ekzistojnë qindra libra dhe dorëshkrime të tjera nëpër librari dhe muzeume me të njëjtën tematikë. Në një studim të kryer në vitin 1985 mbi trashëgiminë islame, S. Abdullah el-Habeshi nga Jemeni përmendi 23 shkrime nga autorë të ndryshëm mbi murtajën dhe sëmundjet infektive. Ai më pas shkroi një liber mbi sëmundjet infektive, bazuar në Mjekësinë Profetike.

Kohët e fundit, numri i publikimeve mbi Mjekësinë Profetike në tërësi apo mbi tema specifike të saj, ka ardhur gjithnjë në rritje. Ka me dhjetëra libra dhe artikuj me referenca nga hadithet përkatëse mbi vetitë kurative të mjaltit, farës së zezë (Nigella Sativa), gjethes së senes (Casiacutifolia), aloes (Aloe Vera), hudhrës dhe qepës, vajit të ullirit, etj. Po ashtu mbi efektet pozitive të qumështit të gjirit, agjërimit, marrjes së abdesit, faljes së namazit, pastrimit të gojës dhe dhëmbëve me misvak etj. Studiuesit kane qenë shumë këmbëngulës në përmendjen e haditheve që promovojnë ruajtjen e shëndetit meqë për çdo besimtar është hadithi ai që e shtyn të zbatojë një porosi të caktuar. Ata kane qenë më të saktë dhe të prerë mbi çështjen e ndalimit të mishit të derrit, gjakut dhe pijeve alkoolike, mbi kryerjen e rrethprerjes, mbi ndalimin e imoralitetit dhe martesën si zgjidhje dhe reagim ndaj përhapjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.

Ka një rritje të interesit gjithashtu mbi mjekësinë psikologjike që trajton problemet shpirtërore duke vënë në dukje shkaktarët e tyre si xhindet keqbërës. Trajtimi i tyre, në ndryshim nga të tjerat, konsiston në recitimin e pjesëve të caktuara të Kur'anit, lutjeve të veçanta të Profetit a.s. dhe yshtjes.

Sigurisht që Islami nuk ka lënë pa përmendur edhe çështjet etike, të cilat po marrin një vëmendje të konsiderueshme ditët e sotme. Ka me qindra artikuj, studime dhe disertacione shkencore mbi transplantimin e organeve, vdekjen e trurit, bebet epruvetë, abortin, kontracëpsionin, klonimin dhe inxhinierinë gjenetike.

Sëmundjet dhe shqetësimet konsiderohen sipas Islamit, të jenë një mënyrë e mirë për të shlyer dhe pastruar mëkatet e njeriut. Ata të cilët nuk ankohen dhe bëjnë durim në raste të tilla të vështira, Allahu i ka premtuar shpërblim të madh në këtë botë dhe në Ditën e Gjykimit. Në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit përmendet hadithi i Profetit a.s. ku thotë: "Në çdo rast kur besimtari goditet nga një sëmundje ose fatkeqësi, atij i janë falur gjynahet e mëparshme". Sidoqoftë Profeti a.s. i ka urdhëruar myslimanët të kërkojnë shërim për sëmundjet në hadithin: "O robërit e Allahut, kërkonin shërim nga sëmundjet, sepse Allahu nuk sjell një sëmundje në këtë dynja dhe të mos e ketë sjellë edhe ilaçin e saj".

### **Disa shembuj të Mjekësisë Profetike** ***Shërimi i temperaturës me ujë***

Abdullah bin Omeri transmeton hadithin që i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Fuqia e temperaturës është ajo që djeg fuqishëm sikur të jetë lëshuar nga zjarri përvëlues i xhehenemit, prandaj duhet ta ftohni atë me ujë". Në të kaluarën ky hadith ka habitur shumicën e mjekëve pa përvojë duke e konsideruar atë të dyshimtë dhe është bërë objekt diskutimesh. Por, sot, duke ndjekur praktikën e mjekësisë moderne, vërejmë se është bërë

zakon që mjekët pediatër të japin këshilla që fëmijës me temperaturë t'i bëhen banja me ujë të ftohtë deri sa t'i ullet temperatura duke vërtetuar se thënia e Profetit a.s. është e vërtetë. Kjo thënie e tij ka dy kuptime: i pari është i përgjithshëm për të gjithë njerëzit dhe i dyti për njerëz të caktuar, kryesisht ata që jetojnë në vende të nxehta si ato të Gadishullit Arabik. Për sa i përket të parit, ka të bëjë me temperaturën e lartë që vjen si pasojë e një infeksioni nga mikrobe të huaja që mund të jenë baktere ose viruse dhe përveç kompresave të ftohta mund të përdoren edhe ilaçe për uljen e saj. Në këtë të fundit temperatura është rezultat i nxehtësisë së ambientit dhe jo nga sëmundje. Kjo lloj temperature gjithashtu mund të ullet duke pirë ujë të freskët ose duke u larë me të. Enesi r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Nëse keni zjarrmi, bëni dush me ujë të ftohtë tre ditë, çdo herë në mëngjes". Në një hadith tjetër, temperatura është përmendur nga një person i cili e ka mallkuar atë si të dëmshme. Kur e ka dëgjuar Profeti a.s. i ka thënë: "Mos e mallko, sepse temperatura e pastron trupin nga mëkatet po në atë mënyrë që zjarri heq papastërtitë nga hekuri". Kjo thënie e të Dërguarit të Allahut a.s. është shumë e vërtetë saqë sot mjekët këshillojnë që temperatura deri në 38°C të mos luftohet, sepse është e dobishme si një mekanizëm imunitar i organizmit.

### **Shërimi me anë të vendosjes së kupave dhe derdhjes së gjakut (Hixhame)**

Sa i përket shërimit të sëmundjeve me anë të vendosjes së kupave dhe lëshimit të gjakut duke prerë lëkurën si masë terapeutike, bazohet në disa hadithe të shënuar në Sahihun e Buhariut dhe Ibni Maxhes. Ndër to mund të përmendim se Ibni Abasi ka treguar se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Është i bekuar ai rob i cili lëshon gjak me anë të prerjes së lëkurës (flebotomia). Kjo pastron gjakun, qetëson pezmatimet e brendshme dhe forcon shikimin", duke e konsideruar këtë si një nga ilaçet më të mirë. Nga Ebu Hurejre tregohet se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Ditët 17, 19 dhe 21 të muajve hënorë janë ditët më të mira për lëshimin e gjakut me anë të prerjes së lëkurës dhe rrjedhjes së tij në kupëzore". Sot, mjekësia është e dyzuar mbi përdorimin dhe efektet e kësaj metode shërimi, por disa efekte pozitive janë të pakundërshtueshme. Është vënë re se në vendin e lëshimit të gjakut në kupë largohen toksinat, agjentët infektiv dhe rritet imuniteti lokal. Po ashtu, kjo mënyrë mund të lehtësojë hipertensionin arterial, sëmundjet kongjestive të mëlçisë e shpretkës dhe sëmundjes së prodhimit të tepërt të gjakut (policitemia vera). Efektet pozitive të lëshimit të gjakut janë edhe në varësi të vendit ku kryhet ajo. P.sh. nëse bëhet në pjesën e përparme të kokës (frontale) ndihmon përmirësimin e kujtesës dhe në pjesën e pasme (okspitale) të saj ndihmon shikimin.

Kur bëhet nën mjekër lehtëson dhimbjet e dhëmbit dhe dhimbjet në fytyrë, në pjesën e mesit të kofshës ndihmon dhimbjet e shpinës dhe nervit shiatik, në pjesën e pasme të gjurit ndihmon shërimin e hemorroideve dhe mosardhjen e menstruacioneve. Siç shihet sëmundjet dhe vendet e aplikimit të saj janë të shumta, aq sa në një tjetër hadith përcillet se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Zbatoni lëshimin e gjakut me anë të prerjes së lëkurës sepse ajo është shërim për 72 sëmundje".

### **Shërimi i dhimbjes së kokës dhe migrenës**

Në përmbledhjen e tij me hadithe, imam Ibn Maxhe ka cituar hadithin në të cilin i Dërguari i Allahut kishte vënë këna në kokë sepse kishte dhimbje të forta dhe kishte thënë: "Me vullnetin e Allahut kjo do të më ndihmojë". Në një tjetër hadith të transmetuar nga Ebu Davudi, Profeti a.s. ka thënë: "Nuk ka bimë më të dashur tek Allahu sesa druri i kënasë". Një tjetër mënyrë për ndalimin e dhimbjes së kokës është lidhja dhe shtrëngimi i saj. Ebu Na'im tregon se i Dërguari i Allahut ndonjëherë vuante nga migrena dhe kjo sëmundje e mbyllte dy ose tre ditë në shtëpi. Ibnu Abasi ka thënë gjithashtu se i Dërguari i Allahut a.s. njëherë kishte mbajtur hytben e së premtes me kokën e lidhur me një shirit.

Dhimbjet e kokës janë disa llojesh dhe dallohen me karakteristikat e tyre të veçanta. Njëri lloj i dhimbjes përfshin të gjithë kokën në formë helmete, forma migrenoze prek vetëm gjysmën e kokës dhe fytyrës duke përfshirë dhe njërin nga sytë dhe dhimbja që prek pjesën e pasme të kokës që është pulsuese. Secili lloj i dhimbjes trajtohet në përputhje me shkaktarin e vet. Ndonjëherë mund të shërohet me purgativë duke nxitur të vjellat ndërsa herë të tjera me pushim dhe çlodhje duke qëndruar larg zhurmave. Dhimbja pulsuese kërkon lidhjen e kokës fort ose vendosjen e kompresave të ftohta sepse shtypja frenon receptorët e dhimbjes. Kuptohet se edhe ilaçet analgjezike apo antimigrenoze janë të efektshme dhe nuk duhen lënë pas dore. Në rastin e dhimbjes migrenoze, trajtimi nga ana e Profetit a.s. me lyerjen e lëkurës së kokës me këna është e pjesshme dhe e kufizuar në vendet e nxehta, por në rast se përdorimi i ilaçeve nuk e qetëson, ia vlen të përdoret kjo metodë si trashëgimi profetike me vlerë. Kënaja në formë pluhuri mund të përzihet edhe me uthull dhe me të të lyhet skalpi i kokës dhe të lihet të veprojë disa orë.

### **Ndikimi i mjekësisë islame në botë**

Mësimet e vyera të Profetit Muhamed a.s. ndryshuan rrënjësisht jetën, besimet dhe zakonet e popujve arabë dhe atyre përreth tyre. Myslimanët u kthyen në një ndriçues dhe udhërrëfyes në atë komunitet injorance sepse Islami i ka frymëzuar ata ta kërkojnë dijen dhe ta ruajnë atë. Në një hadith i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë:

*"Dituria është obligim për çdo mysliman dhe myslimane."*

Pasi Islami ndërtoi një kalifat dhe qytetërim të ri duke futur brenda tij vende dhe popuj të tjerë, dijetaret huazuan nga mjekësia tradicionale e atyre vendeve. Mjekësia greke me punën e dallueshme të Hipokratit dhe Galenit mori shumë përparësi. Ata u morën dhe u përkthyen në gjuhën arabe gjatë kalifatit Abasid në shekullin e 8-9. Teoria dhe praktika së bashku lulëzuan si kurrë më parë në vendet islame ku u projektuan dhe u ngritën spitalet e para. Ata të cilët qenë ideatorët e këtij zhvillimi mbetën të dalluar në historinë e mjekësisë për shekuj me radhe si: el-Razi (v.925), Ibn Sina (Avicena, v.1037), el-Zahraëi (Abuleasis, d.1013), Ibn en-Nafis (d.1288), 'Ali bin al-'Abbas al-Majusi (Haly Abbas, d.994).

Mjekët, farmacistët, kirurgët myslimanë i çuan më përpara dijet e vjetra duke shtuar njohuritë dhe porosinë profetike, gjë e cila është pasqyruar në shkrimin e qindra librave mjekësorë në gjuhën arabe. Megjithatë disa nga punimet origjinale janë zhdukur me kalimin e viteve nga luftërat dhe pushtimet, një numër shumë i madh librash kanë arritur të mbijetojë deri ditët e sotme nëpër biblioteka dhe muze. Për shumë shekuj, literatura islame mbizotëroi botën me dijet e saj mjekësore gjë e cila i dha pikënisjen rilindjes evropiane.

Interesi gjithnjë në rritje për mjekësinë bimore këto dy dekadat e fundit ka qenë një temë shumë e kërkuar nga botuesit në shumë vende të botës. Disa nga shtëpitë botuese kanë filluar të përkthejnë versione të shkurtuara të veprave të Ibn Sina-së. Sidoqoftë, ekzistojnë botime të përjavshme artikujsh me tema të mjekësisë bimore, por kryesisht pa asgjë të re. Mund të përmenden punimet e Dr. Hasan Shemsi Pasha në këtë fushë si një shembull i mirë për studiuesit e rinj. Gjithashtu, shumë qendra kërkimore janë ngritur në vendet arabe për studimin e mjekësisë tradicionale islame dhe asaj bimore. Organizimi i simpoziumeve dhe konferencave i ka dhënë një kurajë të madhe kërkimeve të reja.

Në vendet islame por edhe në ato perëndimore është bërë një punë dhe përpjekje e madhe për rifreskimin e mjekësisë tradicionale dhe Profetike. Megjithatë, akoma ka një nevojë gjithnjë në rritje për integrimin e saj me mjekësinë moderne dhe sistemet shëndetësore shtetërore. Shumica e mjekëve të shkolluar në universitetet e Evropës dhe Amerikës fatkeqësisht nuk kanë as njohuritë më elementare të mjekësisë tradicionale prandaj edhe janë armiq të saj. Kjo sjellje negative nuk do të largohet derisa në kurrikulat e shkollave mjekësore të përfshihen njohuritë për Mjekësinë Profetike dhe atë bimore. Nga ana tjetër, edhe ata që merren me mjekësinë alternative duhet të përmirësojnë standardet e tyre në përputhje me nevojat e kohës.





**BOTIMET KMSH**

# RAMAZAN 2023

1444 HIXHRI

